

---

# KONCEPT PËR ARSIM QYTETAR NË ARSIMIN FILLOR DHE UDHËZIME PËR ZBATIM

---





**United States  
European Command**



**MACEDONIAN  
CIVIC  
EDUCATION  
CENTER**

Koncepti është përgatitur nga grupi punues për avancimin e arsimit qytetar i përbërë nga përfaqësues të Byrosë së Zhvillimit të Arsimit, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Qendrës Maqedonase për Edukim Qytetar, profesorë universitar, mësime dhënë dhe përfaqësues të sektorit civil, me mbështetje të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Përmbajtja e këtij dokumenti u takon autorëve dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) ose të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Aktivitetet për përgatitjen e përmbajtjes së botimit janë realizuar në kuadër të projektit për Integrim Ndëretnik të Rinjëve në Arsim, i zbatuar nga Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar (QMEQ) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Byron për Zhvillimin e Arsimit, dhe Projektit „Përforsimi i bashkëpunimit multi-etnik në komuna“ i Fondacionit të Fëmijëve Pestaloci.

**Bashkëpunëtorët të cilët morën pjesë në zhvillimin e përmbajtjes së këtij publikimi:**

Ajshe Ajrullai  
Anita Angelovska  
Tomislav Gajtanoski  
Loreta Georgieva  
Ardijana Isahi Palloshi  
Natasha Jankovska  
Ilir Memedi  
Gorica Mickovska  
Ana Mickovska Raleva  
Nebojsa Mojsoski  
Dimitar Nizamovski  
Besnik Ramadani  
Oliver Stanojoski  
Hari Stojanoski  
Tatjana Stojanoska Ivanova  
Naziktere Sulejmani  
Zekirija Hasipi  
Mitko Çeshllarov  
Zhaneta Çonteva  
Jovana Gjorgjiovska  
Biljana Trajkovska

# PËRMBAJTJE

I. PARATHËNIE	3
II. ARSIMI QYTETAR: PSE DHE SI TË MËSOHET?	3
II.1. ÇFARË ËSHTË ARSIMI QYTETAR?	3
II.1.1. QASJE DREJT MËSIMDHËNIES SË ARSIMIT QYTETAR	4
II.2. KOMPETENCA QYTETARE: TENDENCA EVROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE	5
II.3. ZHVILLIM I KOMPETENCAVE QYTETARE PËRMES QASJES GJITHËPËRFSHIRËSE	7
III. GJENDJA	9
III.1. PARIME TË ARSIMIT QYTETAR NË POLITIKAT KOMBËTARE	9
III.2. LËNDA ARSIM QYTETAR DERI NË VITIN 2018: PROGRAME MËSIMORE, LIBRA SHKOLLORË DHE PROCES MËSIMOR	10
III.3. IMPLEMENTIM I ASPEKTEVE NGA ARSIMI QYTETAR NË LËNDË TË PËRAFËRTA	12
III.4. KLIMË DEMOKRATIKE NË SHKOLLA	13
IV. KOMPETENCA QYTETARE NË SISTEMIN ARSIMOR TË MAQEDONISË	14
V. KONCEPT I RI I ARSIMIT QYTETAR. FORMAT E ZBATIMIT	17
V.1. LËNDË MËSIMORE ARSIM QYTETAR	17
V.2. PËRFSHIRJA E KOMPETENCAVE QYTETARE NË LËNDË TË TJERA	19
V.3. AKTIVITETE JASHTËSHKOLLORE	20
V.4. METODA MËSIMORE PËR ZHVILLIMIN E KOMPETENCAVE QYTETARE	20
V.4.1. NXËNIE PËRMES PROJEKTEVE	21
V.4.2. NXËNIE PËRMES ZGJIDHJES SË PROBLEMIT	22
V.4.3. DISKUTIM, DEBAT DHE LUAJTJE E ROLEVE	22
V.5. NDJEKJE DHE NOTIM I TË ARRITURAVE	23
V.5.1. NOTIM FORMATIV DHE SUMATIV NË ARSIMIN QYTETAR	24
V.6. ROLI I DREJTORISË SË SHKOLLËS NË ZHVILLIMIN E KOMPETENCAVE QYTETARE TË NXËNËSVE	28
V.7. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË	30
V.8. KOMPETENCA TË MËSIMDHËNËSVE PËR PËRCJELLJEN E DITURIVE, SHKATHTËSIVE DHE QËNDRIMEVE TE NXËNËSIT PËR KULTURËN DEMOKRATIKE DHE QYTETARINË	31
VI. EVALUIM I KOMPETENCAVE TË ARRITURA QYTETARE	32

## I. PARATHËNIE

Koncepti i propozuar i arsimit qytetar në Republikën e Maqedonisë së Veriut për herë të parë e përshkruan qasjen sistemore drejt përvetësimit të kompetencave qytetare dhe jep drejtime për realizimin e tij në shkolla. Dokumenti mbështetet në praktikat ndërkombëtare për zhvillimin e kompetencave qytetare dhe njëherësh është në koordinim me dokumente dhe politika të tjera strategjike kombëtare.

Koncepti rezulton nga *Ligji për arsim fillor* dhe *Strategjia për arsim (2018-2025)* dhe është në drejtim të arritjes së qëllimeve që kanë të bëjnë me: organizimin e përmirësuar të nxënësve dhe pjesëmarrje demokratike në shkollat, si dhe zhvillim të aftësive të nxënësve që të mësojnë dhe zgjidhin probleme, të respektojnë diversitetin dhe të praktikojnë dhe përvetësojnë vlera dhe shkathtësi demokratike.

Qëllimi i përgjithshëm i dokumentit është që të ndihmojë në të kuptuarit e kompleksitetit të përfshirjes së arsimit qytetar në sistemi dhe miratimin se vendosja dhe mirëmbajtja e kulturës demokratike është obligim i gjithë shkollës. Në këtë dokument janë përfshirë edhe udhëzime konkrete për realizimin e arsimit qytetar, duke marrë parasysh nevojën që disa gjëra të sqarohen më gjerësisht bashkë me zgjidhjet konceptuese. Konkretisht, janë përfshirë mënyrat e zbatimit të arsimit qytetar përmes: programeve mësimore nga lënda arsim qytetar dhe lëndët tjera mësimore; aktivitete jashtëshkollore; mënyrat e udhëheqjes së shkollës; format e bashkëpunimit me bashkësinë; metodat e mësimi dhe ndjekjes dhe vlerësimit të të arriturave. Format e zbatimit ndërlidhen mes vete dhe pritet të realizohen në mënyrë koherente në mënyrë që të mundësohen arritje të kompetencave qytetare të nxënësit.

## II. ARSIMI QYTETAR: PSE DHE SI TË MËSOHET?

### II.1. ÇFARË ËSHTË ARSIMI QYTETAR?

Arsimi qytetar sipas UNESCO-s përkufizohet si *“arsimim i fëmijëve, nga fëmijëria e hershme, të bëhen qytetarë që mendojnë qartë dhe në mënyrë të pavarur dhe marrin pjesë në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me shoqërinë në të cilën jetojnë”* (1998)<sup>1</sup>. Në studimin e Evridikës (2017) të Këshillit të Evropës, koncepti i njëjtë përkufizohet si *“fushë mësimore qëllimi i së cilës është promovimi i bashkëjetesës harmonike dhe zhvillim i dobishëm i ndërsjellë i individëve dhe bashkësive të tyre. Në shoqëritë demokratike, arsimi qytetar i nxitë nxënësit të jenë qytetarë aktivë, të informuar dhe të përgjegjshëm, të cilët kanë dëshirë dhe aftësi që të marrin përsipër përgjegjësi për veten dhe për bashkësitë e tyre në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.”*<sup>2</sup>

Pa marrë parasysh përkufizimet e ndryshme, të gjitha organizatat ndërkombëtare që punojnë në politika arsimore bien në dakord se shoqëritë bashkëkohore janë gjithnjë e më komplekse dhe qytetarëve u nevojiten një gamë e gjërë e kompetencave për të qenë produktiv në bashkësinë në të cilën jetojnë, por edhe në botë në përgjithësi. Për shkak të kësaj, arsimi qytetar është gjithnjë e më i rëndësishëm për funksionimin e suksesshëm të individëve në shoqëri dhe për shoqërinë në tërësi. Ekziston pajtueshmëri e përgjithshme se shkolla është një prej sistemeve themelore për përcjelljen e vlerave dhe qëndrimeve qytetare, me ç’rast nxënësit nuk duhet vetëm të përgatiten për zbatimin e tyre në „jetën reale” që do të vijojë pas përfundimit të shkollimit, por edhe t’i praktikojnë në jetesën e përditshme në shkollë dhe jashtë saj. Për nxënësit, shkolla dhe periudha e shkollimit janë jeta reale në të cilën duhet t’i përvetësojnë vlerat, qëndrimet dhe shkathtësitë qytetare dhe t’i zbatojnë në sjellje.

<sup>1</sup> UNESCO. (1998). *Citizenship Education for the 21st Century*. Paris: UNESCO.

<sup>2</sup> European Commission/EACEA/Eurydice. (2017). *Eurydice Report: Citizenship Education at School in Europe – 2017*, faq.9..

Shkurtimisht, **qëllimi i arsimit qytetar është t'i aftësojë dhe forcojë nxënësit për të qenë qytetarë të përgjegjshëm, aktivë, të cilët do t'i ushtrojnë në mënyrë efektive rolet e tyre në shoqëri.** Sjelljen e përgjegjshme dhe aktive, ata fillimisht duhet ta zhvillojnë në nivel të bashkësisë së klasës dhe shkollës, e gradualisht ta bartin edhe në bashkësinë lokale, shtetërore dhe globale. Arsimi qytetar **përfshin dituri, shkathtësi, por edhe qëndrime dhe vlera që duhet të shpijnë drejt sjelljes qytetare.** Për të qenë qytetarë të përgjegjshëm të cilët do të punojnë në mënyrë aktive në përmirësimin e bashkësisë, nxënësve nuk u mjafton, për shembull, vetëm t'i njohin të drejtat e njeriut, institucionet shtetërore dhe konceptet dhe proceset politike, por të drejtat dhe përgjegjësitë duhet edhe t'i praktikojnë në kuadër të shkollës dhe bashkësisë. Për shkak të kësaj, në bazë të arsimit qytetar janë metodat e nxënies përmes bashkëveprimit, përvojës personale dhe nxënies përmes angazhimit në bashkësinë. Këto metoda janë të lidhura me nxënien përmes hulumtimit, analizës dhe vlerësimit të informacioneve, me qëllim të zhvillimit të vlerave që nuk përjetojnë si të imponuara, por rezultojnë nga përvoja e individëve.<sup>3</sup>

### II.1.1. QASJE DREJT MËSIMDHËNIES SË ARSIMIT QYTETAR

Në materiale letrare takohen ndarje të ndryshme të modeleve të mësimdhënies së arsimit qytetar, të përgatitura në përputhje me qëllimet dhe kompetencat që duhet të arrihen, dhe në bazë të statusit të programit mësimor (lëndë e posaçme, lëndë zgjedhore, mësimdhënie ndërmjet-lëndore, aktivitet jashtëshkollorë, etj.). Në raportin më të ri të Evridikës (2017) si **mënyra më të shpeshta të vendosjes/integrimit të arsimit qytetar në sistemin arsimor** përmenden<sup>4</sup>:

- (1) **Mësimdhënie e detyrueshme ndërmjet-lëndore e arsimit qytetar.** Në sistemet në të cilat arsimi qytetar është temë ndërmjet-lëndore, statusi dhe qëllimi i së njëjtës është arsyetuar në kurikulimet e përgjithshme kombëtare, në kapitujt që kanë të bëjnë me lëndë konkrete. Kjo mund t'i përfshijë pjesët në të cilat përpunohen shkathtësitë, kompetencat ose temat ndërmjet-lëndore. Kjo qasje zakonisht përdoret në kombinim me qasje të tjera. Në disa sisteme të caktuara, për këtë temë transversale janë parashikuar edhe korniza të posaçme kohore, gjegjësisht periudhë gjatë javës gjatë së cilës e njëjta duhet të përpunohet/integrohet.
- (2) **Lëndë e detyrueshme mësimore ose qëllime/përmbajtje të detyrueshme në kuadër të ndonjë lënde tjetër të detyrueshme.** Në pjesën më të madhe të sistemeve evropiane, arsimi qytetar zakonisht është i integruar në lëndë/fusha të tjera të nxënies. Megjithatë, nëse mësohet përmes lëndës së posaçme, integrimi ndërmjet-lëndor është sërish i përfaqësuar – zakonisht në lëndët e shkencave shoqërore dhe lëndët që kanë të bëjnë me arsimin për vlera (etikë, religjion), gjuhë dhe letërsi.

Në raportin e Evridikës (2005)<sup>5</sup> **mënyrat e mësimdhënies** ndahen në grupe si vijon, **sipas fokusit të nxënies:**

- (1) **Përvetësim i diturive teorike** (të drejtat e njeriut, demokracia, institucione politike dhe shoqërore), kryesisht të fokusuar në zhvillimin e kulturës politike mes nxënësve. Kjo qasje në përgjithësi karakterizohet me bartje pasive të informacioneve, ndërsa të arriturat e nxënësve mund të maten përmes provimeve (me teste ose forma të tjera të notimit).
- (2) **Zhvillim të nxënësve si qytetarë të përgjegjshëm**, përmes nxënies së respektimit të vetvetes dhe të tjerëve, zgjidhjen e qetë të konflikteve, zhvillim të perspektivës globale për shoqërinë, etj. Fokusi është në qëndrimet dhe vlerat e nxënësve, që janë kompetenca që maten më vështirë.
- (3) **Promovim i pjesëmarrjes aktive të nxënësve** përmes përfshirjes së tyre në jetën shoqërore, politike dhe kulturore. Lloji i këtillë i programeve kanë për qëllim t'i zhvillojnë kompetencat e

<sup>3</sup> Hrvatski Nacionalni Kurikulum. (2016). Međupredmetne teme. Građanski odgoj I obrazovanje. Prijedlog, Vejjača 2016.

<sup>4</sup> European Commission/EACEA/Eurydice. (2017). Eurydice Report: Citizenship Education at School in Europe – 2017.

<sup>5</sup> European Commission/EACEA/Eurydice. (2005). Eurydice Report: Citizenship Education at School in Europe. Brussels: Eurydice.

nxënësve për pjesëmarrje në bashkësinë në mënyrë konstruktive dhe kritike. Nxënësit duhet të eksperimentojnë me zbatimin e parimeve demokratike në praktikë, në dhe jashtë klasës. Prej tyre pritet të zbatojnë atë që e kanë mësuar gjatë periudhës së sipërpërmendur, në mënyrë që ta kuptojnë rëndësinë e pjesëmarrjes aktive.<sup>6</sup>

Në mënyrë plotësuese, programet mësimore në lëndë të ndryshme, në disa shtetet, përmbajnë pjesë që kanë të bëjnë me mënyrat në të cilat përmbajtjet e lëndëve dhe mënyrat e punës gjatë orëve do të kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave kyçe, duke përfshirë edhe kompetencat qytetare.<sup>7</sup>

## II.2. KOMPETENCA QYTETARE: TENDENCA EVROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE

Hulumtimi i paradokohshëm i Evridikës (2017) për arsim qytetar në Evropë tregon se shtetet evropiane i kushtojnë rëndësi gjithnjë e më të madhe zhvillimit të kompetencave qytetare dhe për këtë qëllim zbatojnë reforma në sistemet arsimore. Nevoja rezulton nga dinamika e dukurive globale dhe domosdoshmërisë së zhvillimit të strategjive për mirëkuptim dhe përballje me një numër të madh të informacioneve të ndryshme, potenciale të konfliktit. Në vazhdimësi, të gjithë kreatorët e rëndësishëm të politikave globale arsimore kanë tendencë që t'i operacionalizojnë kompetencat qytetare në mënyrë që të zhvillohen politika përkatëse për përvetësimin, ndjekjen dhe matjen e tyre.

Konkretisht, zhvillimi i kompetencave sociale dhe qytetare dhe promovimi i barazisë, kohezionit shoqëror dhe qytetarisë aktive përmes arsimit, paraqet njërin nga qëllimet kryesore të „Arsim dhe trajnim” 2020 (Education and Training 2020); kornizë referente e OECD-së për arsim 2030, korniza e UNESCO-s Arsimit 2030; si dhe Korniza evropiane e kompetencave kyçe për nxënie të përvetshme.

Korniza e **kompetencave kyçe për nxënie të përvetshme, e propozuar nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Evropës**<sup>8</sup>, e zhvilluar në vitin 2006, në versionin e parë të kompetencave kyçe, e përmbante konceptin dual të “kompetencave sociale dhe qytetare” që përfshinte perspektivë personale dhe shoqërore. Në këtë dokument, kompetenca qytetare përkufizohej si *“aftësim të individëve për pjesëmarrje të tërësishme në jetën qytetare, në bazë të njohjes së koncepteve dhe strukturave shoqërore e politike dhe përkushtimit ndaj pjesëmarrjes aktive dhe demokratike”*. Me revizionin e Kornizës në vitin 2018, koncepti **“kompetencë qytetare”** i merr parasysh ndryshimet globale, shoqërore, ekonomike dhe ekologjike, si dhe zhvillimin e zgjidhjeve novatore për probleme me të cilat do të përballemi më tej. Zhvillimi i qëndrueshëm nënkupton dituri, shkathtësi dhe qëndrime për përballje me ndryshim dhe pasiguri, të menduarit dhe veprim kritik, kreativitet dhe aftësi për vlerësimin dhe marrjen përsipër të rreziqeve.<sup>9</sup>

Këshilli i Evropës para do kohë zhvilloi **“Kornizë të kompetencave për kulturë qytetare”**<sup>10</sup> që është e gjërë. Kompetencat mbulojnë vlerat, qëndrimet, shkathtësitë, dituritë dhe të kuptuarit kritik, që kanë të bëjnë me konceptin e qytetarisë (Foto 1).


<sup>6</sup> Eurydice (2005), sipas Navarro-Medina, Elisa & De-Alba-Fernández, Nicolás. (2015). Citizenship Education in the European Curricula. *Procedia - Social and Behavioral Sciences*. 197. 45-49. 10.1016/j.sbspro.2015.07.381.

<sup>7</sup> Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar. (2014). Programi i lëndes se historise ne arsimin baze shkalla e dyte dhe e trete. Republika E Shqipërisë. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

<sup>8</sup> Council of Europe. (2007). *Key Competences for Lifelong Learning. European Reference Framework*. Recommendation of the European Parliament and of the Council of 18 December 2006 on Key Competences for Lifelong Learning (2006/962/EC).

<sup>9</sup> European Union. (2019). *Key Competences for Lifelong Learning*. European Union.

<sup>10</sup> Barrett, M. D. (2016). *Competences for democratic culture: Living together as equals in culturally diverse democratic societies*. Council of Europe Publishing.

**Foto 1.** Kompetenca për kulturë qytetare, Këshilli i Evropës (2016)

Në përputhje me këto kompetenca është edhe iniciativa për **Arsim Global Qytetar** (Global Citizenship Education (GCED)) e zhvilluar nga UNESCO, qëllimi i së cilës është *“forcimi i nxënësve nga të gjitha moshat që të ndër marrin role aktive, në nivel lokal dhe global, në mënyrë që të ndërtohen shoqëri më të qeta, më tolerante, gjithëpërfshirëse dhe të sigurt”*.<sup>11</sup> Iniciativa mbështetet në tri fusha të nxënies:

1. **Kognitive:** dituri dhe shkathtësi të të menduarit, të domosdoshme për të kuptuarit më të mirë të botës dhe kompleksitetit të saj.
2. **Socio-emocionale:** vlera, qëndrime dhe shkathtësi sociale që u mundësojnë nxënësve të zhvillohen në mënyrë afektive, filozofike dhe fizike, si dhe të jetojnë në paqe dhe mirëkuptim me të tjerët.
3. **Bihevoriste:** sjellje, zbatim praktik dhe përfshirje.

Aktivitetet e UNESCO-s në këtë fushë udhëhiqen nga *Agjenda e arsimit 2030*, ndërsa qëllimi konkret 4.7. nga qëllimet për zhvillim të qëndrueshëm u bën thirrje shteteve që deri në vitin 2030 të *“sigurojnë që të gjithë nxënësit të kenë dituri dhe shkathtësi për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm, përfshirë edhe përmes arsimit për zhvillim të qëndrueshëm edhe stileve të qëndrueshme të jetës, të drejta të njeriut, barazi gjinore, promovim të kulturës së paqes dhe jo-dhunës, qytetari globale dhe vlerësim të diversitetit kulturor dhe kontributit të kulturës drejt zhvillimit të qëndrueshëm”*.<sup>12</sup>

Në mënyrë plotësuese, karakteristikat e të a.q. **“Kompetencë globale”**, të zhvilluar nga OECD-ja, në pjesën më të madhe përputhen me aspektet që i mbulon koncepti i Arsimit Global Qytetar të UNESCO-s. Konkretisht, konsiderohet se *“në aspektin global individët dinë të analizojnë tema lokale, globale dhe ndërkulturore, të kuptojnë dhe vlerësojnë perspektiva dhe këndvështrime të ndryshme për botën,*

<sup>11</sup> UNESCO. *Global Citizenship Education (GCED)*. E kapshme në: <https://en.unesco.org/themes/gced>

<sup>12</sup> UNESCO. *Learning to live together sustainably (SDG4.7): Trends and Progress*. E kapshme në: <https://en.unesco.org/themes/gced/sdg47progress>

të bashkëpunojnë me sukses dhe me respekt me të tjerët dhe të ndërmarrin aksione të përgjegjshme drejt qëndrueshmërisë dhe mirëqenies kolektive". Konsiderohet se shkollat kanë rol veçanërisht të rëndësishëm në zhvillimin e kompetencës globale të rinjtë përmes: ofrimit të mundësive për analizim kritik të çështjeve globale që janë të rëndësishme për botën në tërësi dhe për jetët e tyre. Shkollat mund t'i mësojnë nxënësit se si t'i shfrytëzojnë në mënyrë kritike, efektive dhe të përgjegjshme informacionet dhe platformat digjitale në mediat sociale; të inkurajojnë ndjeshmëri dhe respektim ndërkulturor ashtu që do t'u mundësojnë nxënësve të përfshihen në përvoja që nënkuptojnë respektim të njerëzve, gjuhëve dhe kulturave të ndryshme. Shkollat gjithashtu janë në gjendje të forcojnë aftësinë e personave të rinj për të kuptuar rolin e tyre në bashkësi dhe në botë, dhe të përmirësojnë aftësinë e tyre për të marrë vendime dhe për të ndërmarrë një veprim.<sup>13</sup>

Të gjitha këto struktura në esencën e tyre janë shumë të ngjashme dhe përfshijnë disa **koncepte kyçe**, siç janë: sjellje që nënkupton **pjesëmarrje aktive, stile të qëndrueshme jetësore**, si dhe **tolerancë dhe inkluzivitet**. Këto janë karakteristikat që duhet t'i posedojnë nxënësit për të qenë kompetentë në aspektin qytetar. Për shkak të kompleksitetit të tyre, nuk mund të pritët që nxënësit t'i përvetësojnë gjatë orëve të arsimit qytetar, por përvetësimi i tyre duhet të jetë përfshirë në të gjitha politikat dhe praktikat shkollore.

#### Shembulli 1: Përvoja evropiane në zhvillimin e kompetencave qytetare

Shtetet evropiane i rishikojnë programet e tyre mësimore me politika që kanë të bëjnë me zhvillimin e kompetencave shoqërore, qytetare dhe interkulturore, mendimit kritik dhe arsimit mediatic ose promovimin e dialogut ndërkulturor. Sipas raportit të Evridika (2017), pas miratimit të Deklaratës së Parisit, dy të tretat e shteteve të përfshira me hulumtimin kanë vendosur nisma të reja arsimore në drejtim të miratimit të kompetencave të përmendura. Ato kanë të bëjnë me ndryshimin në përmbajtjet që mësohen, notimin e nxënësve, pjesëmarrjen e nxënësve në aktivitete edhe jashtë shkollës dhe zhvillimin profesional të mësimeve.

Për shembull, reforma në programet mësimore norvegjeze përfshin dhënien e prioritetit në temat si vijon: demokraci dhe qytetari, zhvillim të qëndrueshëm, shëndet publik dhe shkathtësi jetësore. Nga ana tjetër, në Islandë janë vendosur disa shtylla të programeve mësimore: demokraci dhe të drejtat e njeriut, barazi, qëndrueshmëri dhe mirëqenie, ndërsa ndryshimi afatgjatë që pritët të arrihet është – promovimi i ndryshimit në praktikat shkollore dhe epilogët arsimor, forcim i vlerave demokratike, i mendimit kritik dhe arsimit etik. Në Austri ekziston një universitet që ofron program specialist pas diplomimit nga Arsimi Global Qytetar, ndërsa Qendra e Arsimit Qytetar në Shkolla është institucioni qendror arsimor dhe shërbim për arsim qytetar që zhvillon materiale mësimore, zbaton edukim dhe mentorim të mësimeve, organizon ngjarje për nxënësit (në mesin e të cilave edhe Ditët qytetare austriake).

Në mënyrë plotësuese, me programet e financuara nga BE-ja (me së shumti përmes Erasmus + programit) janë mbështetur aktivitete për zhvillimin e materialeve mësimore dhe qasje kreative për promovimin e qytetarisë aktive dhe qëndrueshmërisë, si dhe ngritjen e vetëdijes ndërkulturore.

Burimi: European Commission/EACEA/Eurydice. (2017). Eurydice Report: Citizenship Education at School in Europe – 2017.

### II.3. ZHVILLIM I KOMPETENCAVE QYTETARE PËRMES QASJES GJITHËPËRFSHIRËSE

Përvetësimi i kompetencave qytetare është më efikas nëse mbështetet në qasje gjithëpërfshirëse. Kjo qasje përfshin integrimin e vlerave dhe parimeve të demokracisë dhe të drejtave të njeriut në të gjitha aspektet e jetës shkollore, duke përfshirë programet mësimore, metodat dhe resurset për mësim dhe

<sup>13</sup> OECD. (2018) *PISA. Preparing our Youth for an Inclusive and Sustainable World*. The OECD PISA Global Competence Framework, OECD Directorate for Education and Skills.



nxënie, notimin, udhëheqjen, menaxhimin, strukturën dhe procesin e vendimmarrjes, politikat dhe kodekset e sjelljes, marrëdhëniet mes të punësuarve dhe nxënësve, aktivitetet jashtëshkollore dhe bashkëpunimi me bashkësinë. Qasja gjithëpërfshirëse krijon atmosferë shkollore në të cilën vlerat dhe parimet e demokracisë dhe të drejtave të njeriut mund të jenë të hulumtuara, provuara dhe kuptuara në mënyrë të sigurt dhe të qetë.<sup>14</sup>

Ndonëse mësimi për qytetari demokratike përmes kritikave në shkollë nuk është proces i thjeshtë, hulumtimet<sup>15</sup> tregojnë se është mënyrë efektive për përvetësimin e kompetencave qytetare. Kjo, në esencë, kërkon reforma të programeve mësimore, politika arsimore dhe procedura administrative dhe juridike në shkollat. Kjo qasje kërkon përfshirje të plotë dhe të përhershme nga drejtorja e shkollës, mësimdhënësit dhe prindërit/kujdestarët.<sup>16</sup> Njëherësh, shkolla duhet t'i përfshijë nxënësit në të gjitha aspektet e jetës së shkollës për të cilat nxënësit mund të kenë/japin mendimin e tyre, dhe nëse është e mundur, t'u jepet nxënësve përgjegjësi për udhëheqjen e aktiviteteve të caktuara në shkollë. Ndjenja se "shkolla u takon të gjithëve" ka potencial për të rritur motivimin për nxënie.<sup>17</sup>

Për të ndodhur këto ndryshime, nevojitet që shkollat:

- Të jenë sa është e mundur më demokratike, e jo vetëm të realizojnë mësim për demokracinë.
- Të punojnë në mënyrë aktive zhvillimin e qëndrimeve demokratike të nxënësve dhe të krijojnë mundësi për zbatimin e tyre në shkollë, e jo vetëm t'i aftësojnë nxënësit për rolin e tyre të ardhshëm si qytetarë.
- Të zhvillojnë lidhje me agjentët e jashtëm të socializmit, në mënyrë që të krijojnë mjedis për nxënie që e karakterizon klimën e mirëfilltë demokratike që mundëson pjesëmarrje të drejtpërdrejtë nga nxënësit në aktivitetet e përditshme në shkollë.<sup>18</sup>

Përfitime nga qasja e këtillë kanë<sup>19</sup>:

#### Shkolla:

- ✓ Është përforcuar pjesëmarrja e nxënësve dhe liria e shprehjes së mendimeve.
- ✓ Është përmirësuar udhëheqja në mesin e nxënësve.
- ✓ Është forcuar shkolla si bashkësi.
- ✓ Është përmirësuar sjellja e nxënësve.
- ✓ Është rritur motivimi dhe të arriturat.

<sup>14</sup> Council of Europe. (2018). *Reference Framework of Competences for Democratic Culture. Volume 3: Guidance for implementation*. Council of Europe.

<sup>15</sup> Torney-Purta, J. (2000). *Comparative perspectives on political socialization and civic education*.

Finkel, S. (2000). *Civic Education and the Mobilization of Political Participation in Developing Democracies*. Paper prepared for the conference, Political Participation: Building a Research Agenda, Princeton University, October 12-14.

Széger, K. (2012). *Policy Recommendation for the Development of Education for Democratic Citizenship in Elementary and Secondary Schools*, Kurt Lewin Foundation.

Capacci, C. C., & Pozniak, M. (2004). *Creating partnerships, educating children: case studies from Catholic Relief Services*. Catholic Relief Services.

<sup>16</sup> Dürr, K. (2005). *The school: A democratic learning community*. The All-European Study on Pupils' Participation in School. Council of Europe.

<sup>17</sup> Advisory Group on Citizenship. (1998). *Education for Citizenship and the Teaching of Democracy in Schools. Final Report of the Advisory Group on Citizenship*. Qualifications and Curriculum Authority.

<sup>18</sup> Ibid.

<sup>19</sup> Kerr, D. (2017). *Why citizenship education in schools?* The Citizenship Foundation.

European Commission/EACEA/Eurydice. (2005). *Eurydice Report: Citizenship Education at School in Europe*. Brussels: Eurydice.

**Nxënësit:**

- ✓ Kanë mundësi që në mënyrë të përgjegjshme të përfshihen në vendimmarrjen.
- ✓ U ndihmon t'i shprehin qëndrimet e tyre.
- ✓ Përmirëson vetëbesimin.
- ✓ U mundëson të kontribuojnë në dhe jashtë shkollës.
- ✓ I zhvillojnë shkathtësitë e shprehjes së mendimeve, udhëheqjes dhe punës ekipore.
- ✓ Përmirëson të arriturat.
- ✓ I përgatitë për jetë si persona të rritur.

**Bashkësia më e gjerë:**

- ✓ E përfshin shoqërinë qytetare në klasë.
- ✓ Ndihmon në kalimin nga arsimi fillor në atë të mesëm dhe nga procesi arsimor drejt punës.
- ✓ Lidhë shkollën me bashkësinë lokale.
- ✓ Zhvillon shkathtësitë e personave të rinj për pjesëmarrje në jetën në bashkësi.
- ✓ Zhvillon persona të rinj të cilët janë të interesuar dhe kanë qëndrim për çështjet e rëndësishme në shoqëri.

### III. GJENDJA

#### III.1. PARIME TË ARSIMIT QYTETAR NË POLITIKAT KOMBËTARE

Politikat themelore arsimore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përmes dokumenteve të miratuara, i reflektojnë parimet e arsimit qytetar, gjegjësisht vlerat, qëndrimet dhe sjelljet qytetare. Konkretisht, **Ligji i arsimit fillor** ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 161/19), në nenin 5 ndalon çdo lloj diskriminimi. Më tutje, në nenin 7, ku janë përkrahur qëllimet e arsimit fillor, janë përfshirë edhe parimet e: zhvillimit të vetëbesimit dhe vetëdijes te nxënësi për individualitet personal dhe përgjegjësi për veprimet e tij; edukim për respektimin e dallimeve, bashkëpunim, respektim të diversiteteve, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut; dhe përgatitje të nxënësit për jetë të përgjegjshme në shoqëri të lirë, qytetare dhe demokratike; si dhe arritje të standardeve kombëtare për nxënësit në arsimin fillor nga fusha **kulturë dhe qytetari demokratike**.

Në pjesën e ligjit që e rregullon planifikimin e punës së shkollës fillore (neni 49), parashikohet që programi vjetor i shkollës të përfshijë: promovim të gjendjes së mirë të nxënësve, mbrojtje nga dhuna, nga keqpërdorimi dhe braktisja, parandalim të diskriminimit; orientim profesional të nxënësve; integrim ndëretnik dhe nisma të përbashkëta të nxënësve; bashkëpunim me prindërit gjegjësisht kujdestarët; aktivitete për mbrojtje të mjedisit jetësor, dhe përmbajtje të tjera që kanë potencial për t'i zhvilluar kompetencat qytetare.

Ligji i kushton vëmendje të veçantë organizimit dhe pjesëmarrjes së nxënësve (neni 68) si forma përmes të cilave duhet të nxitet dhe mirëmbahet demokracia në shkollë. Në këtë kontekst, *Parlamentit të nxënësve* u janë dhënë mundësi për pjesëmarrje në: përgatitjen e programit vjetor të punës, promovimin e aktivizmit të nxënësve, përfaqësimin dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të nxënësve, vlerësimin e punës së shkollës, organizimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete humanitare, aktivitete ekologjike dhe punë të dobishme shoqërore, etj. Në mënyrë plotësuese, Ligji parashikon edhe përzgjedhje të *Avokatit të nxënësve* i cili do të kujdeset për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të nxënësve në shkollë. Më në fund, ligji përfshin angazhimin për konsultimin e nxënësve për çështje që kanë të bëjnë me realizimin e procesit arsimor dhe respektimin e mendimeve të tyre.

**Strategji për arsim (2018-2025)**, duke dalluar se mbështetja për pjesëmarrjen demokratike të nxënësve është e pamjaftueshme në shumicën e shkollave, si pjesë e prioriteteve parashikon përfshirjen e parimeve të barazisë dhe drejtësisë gjatë zhvillimit të standardeve kombëtare për secilin cikël të arsimit

fillor, me vëmendje të posaçme në inkluzivitetin, respektin e diversiteteve, të drejtave të fëmijëve dhe kulturës demokratike. Si rrjedhojë, rezultatet nga nxënia përfshijnë: aftësi të zhvilluara të nxënësve për të mësuar dhe zgjidhur probleme, për t'i respektuar diversitetet dhe multikulturalizmin dhe për të përvetësuar vlera dhe shkathtësi demokratike; si dhe qasje deri te librat cilësor dhe aktual shkollor si burim i diturive aplikative që promovojnë të drejta të njeriut, respektim të diversiteteve dhe vlerave demokratike.

**Standardet dhe kompetencat për mësimdhënës** (BZHA dhe MASH, 2020) përfshijnë vlera, kuptime dhe njohuri profesionale, si dhe aftësi dhe shkathtësi profesionale në gjashtë fusha. Mes tyre gjenden kompetenca të shumta qytetare, si për shembull: përballje me raste të dhunës dhe diskriminimit mbi çfarëdo baze; njohje të karakteristikave dhe mënyrave për krijimin e klimës pozitive për nxënie, aktivitete për multikulturalizëm, interkulturalizëm, integrim ndëretnik dhe pjesëmarrje demokratike në gjatë mësimin dhe aktiviteteve jashtëshkollore; njohje e mënyrave të ndryshme të bashkëpunimit me familjen dhe bashkësinë lokale dhe mundësi për pjesëmarrjen e tyre në jetën e shkollës.

**Treguesit e cilësisë së punës së shkollave** (ISHA, 2020) gjithashtu në nivel të kënaqshëm e reflektojnë angazhimin për shkolla demokratike, veçanërisht përmes treguesve që kanë të bëjnë me vlerësimin e "Klimës shkollore dhe marrëdhënieve në shkollë", "Barazi dhe drejtësi" dhe "Raport partner me prindërit dhe me bashkësinë lokale dhe afariste".

**Koncepcioni për edukim dhe arsim fillor nëntëvjeçar** (MASH, BZHA, 2007), ndonëse është dokument më i vjetër, në pjesën që ka të bëjë me parimet e edukimit dhe arsimin fillor, mes tjerash, i përfshin parimet e: demokracisë, mosdiskriminimit, pjesëmarrjes aktive të nxënësve në jetën e shkollës, të kuptuarit e të tjerëve dhe multikulturalizëm dhe partneritetet mes shkollës, prindërve dhe mjedisit lokal.

**Koncepcioni për aktivitete jashtëshkollore** (BZHA, 2020), gjithashtu është harmonizuar me konceptin e ri të arsimin qytetar, përmes përfshirjes së aksioneve në shkollë dhe bashkësi, organizimit të nxënësve dhe nismave të nxënësve si pjesë e aktiviteteve jashtëshkollore.

**Ligji për pjesëmarrje rinore dhe politika rinore** („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 10/20) për herë të parë garanton pjesëmarrje rinore në proceset lokale dhe kombëtare të krijimit të politikave rinore përmes mundësisë së barabartë për përfshirjen e të gjitha formave të bashkimit rinor, në mesin e të cilave edhe të bashkësive të shkollave. Në nenin 5 të Ligjit ku janë përmendur parimet themelore të tij; barazi, mundësi të barabarta dhe ndalesë të diskriminimit; pavarësi, pluralizëm dhe demokraci në të gjitha format e organizimit rinor; avancimin e vetëdijes për rëndësinë e të rinjve dhe rolin e tyre shoqëror; multikulturalizmi, interkulturalizmi dhe inkluziviteti në pjesëmarrjen aktive të të rinjve; përfshirje ndëretnike dhe ndërlidhje me organizimin dhe udhëheqjen rinore të politikave publike rinore; si dhe përgjegjësi dhe solidaritet të të rinjtë.

Mund të konstatohet se në vend nuk mungojnë dokumente strategjike dhe dispozita ligjore që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen demokratike të nxënësve, nxitjen e vlerave dhe sjelljeve qytetare dhe zhvillimin e qytetarëve të përgjegjshëm dhe aktiv. Përkundrazi, politikat kyçe që e rregullojnë arsimin formal i përfshijnë këto parime si bazë e procesit edukativo-arsimor.

### III.2. LËNDA ARSIM QYTETAR DERI NË VITIN 2018: PROGRAME MËSIMORE, LIBRA SHKOLLORË DHE PROCES MËSIMOR

Lënda mësimore arsim qytetar, për herë të parë është vendosur si lëndë e detyrueshme në planin mësimor në vitin 2002. Në planin aktual mësimor për arsimin fillor nëntëvjeçar, lënda mësimore arsim qytetar mësohet në periudhën e tretë zhvillimore me status të lëndës së detyrueshme në klasën e VIII-të dhe IX-të me nga një orë në javë, gjegjësisht 36 orë në vit.

Në programet mësimore nga lënda e arsimit qytetar të vitit 2008<sup>20</sup>, janë dhënë qëllime zhvillimore për periudhën, në bazë të të cilave konkretizohen qëllimet dhe përmbajtjet në çdo klasë. Numri më i madh i qëllimeve kanë të bëjnë me njoftimin e idesë për të drejtat e njeriut, *Deklaratën universale për të drejtat e njeriut*, *Konventën evropiane për të drejtat e njeriut*, lidhshmërinë mes të drejtave, lirive dhe përgjegjësi të njeriut dhe gjendjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut në shtetin tonë, rëndësinë e anëtarësimit të shtetit në Bashkimin Evropian, karakteristikat e pushtetit, mas-mediat, zgjidhjen e konflikteve dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare.

Në vitin 2016, Byroja e Zhvillimit të Arsimit inicioi realizim të studimit për analizimin e realizimit të arsimit qytetar në arsimin fillor. Studimi ka të bëjë me mësimdhënien e lëndës arsim qytetar në klasën e tetë dhe të nëntë, sipas programit mësimor të miratuar në vitin 2008, dhe librat shkollor të botuar në vitin 2009 dhe 2010. Në bazë të anketës elektronike dhe grupeve të fokusit me mësimdhënës dhe nxënës është ardhur deri te përfundimet vijuese:

- **Programi mësimor.** Mësimdhënësit kanë qëndrim kryesisht pozitiv për programin mësimor dhe mundësinë për arritjen e qëllimeve të parashikuara në program, derisa vetëm një prej dy nxënësve të anketuar kanë konsideruar se lënda u ka ndihmuar që t'i arrijnë qëllimet e parashikuara në program.
- **Metoda mësimore.** Ndonëse programi mësimor nuk i kufizon mësimdhënësit lidhur me përdorimin e metodave mësimore, dhe në fakt rekomandon përdorimin e metodave të llojllojshme interaktive, sipas të dhënave, dominojnë ato tradicionale (metoda fonologjike dhe tekstuale). Megjithatë, ajo që është më brengosëse është se vetëm 57% e nxënësve janë përgjigjur se mund t'i shprehin lirshëm mendimet e tyre gjatë orëve të arsimit qytetar, e dhënë që vetvetiu bën të ditur se nuk arrihet një nga qëllimet kryesore të lëndës.
- **Libra shkollorë.** Thujse gjysma e mësimdhënësve konsiderojnë se në librat shkollor që përdoren ka tema, përmbajtje, nocione që nuk janë përkatëse për moshën e nxënësve ose nga ana tjetër janë prezantuar gabimisht (gjegjësisht nuk janë në përputhje me zhvillimin bashkëkohor të shoqërisë). Në mënyrë plotësuese, çdo i dyti nxënës është kritik lidhur me rolin që libri shkollor e ka në nxënien dhe sqarimin e përmbajtjeve dhe koncepteve.<sup>21</sup>

Ndonëse qëndrimet për programin mësimor janë në përgjithësi pozitive, duke marrë parasysh rrjedhat më të reja të zhvillimit të arsimit qytetar, ishte e domosdoshme që të shqyrtohet se sa ato përkojnë me konceptet bashkëkohore dhe cili është potenciali i tyre për zhvillimin e kompetencave qytetare. Me këtë qëllim, është realizuar një hulumtim në të cilin janë analizuar programet mësimore për klasën e tetë dhe të nëntë të vitit 2008 dhe librat shkollorë janë shfrytëzuar për realizimin e programit mësimor<sup>22</sup>, nga aspekti i përshtatjes së tyre me komponentët individuale të kompetencës qytetare të zhvilluar në kuadër të *Kompetencave kyçe për nxënie të përjetshme* nga Këshilli i Evropës. Hulumtimi vërtetoi se në programin mësimor qëllimet që kanë të bëjnë me përvetësimin e diturive janë të përfaqësuara më së

<sup>20</sup> Byroja e Zhvillimit të Arsimit. (2008). Program mësimor nga arsimit qytetar për klasën e VIII-të.

Byroja e Zhvillimit të Arsimit. (2008). Program mësimor nga arsimit qytetar për klasën e IX-të.

<sup>21</sup> G. Mickovska, M. Çeshllarov & A. Mickovska Raleva (2016). Realizim i arsimit nga arsimit qytetar në shkollat fillore: Raport nga hulumtimi. Shkup: Qendra Maqedonase për Arsim Qytetar.

<sup>22</sup> G. Trajkova Kostovska, K. Ugrinovski & K. Vasilevski (2009). Arsim qytetar për klasën e 7-të. Shkup: Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

K. Ugrinovski & K. Vasilevski (2010). Arsim qytetar për klasën e 8-të. Shkup: Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

shumti (njohje e institucioneve dhe organizatave vendore dhe ndërkombëtare, dokumente, etj.), derisa nuk është i përfaqësuar sa duhet dimensionin e shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave. Në mënyrë plotësuese, asnjëri prej qëllimeve të parashikuara në programin mësimor nuk ka të bëjë me sjelljen e pritur nga nxënësit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse merret parasysh se qëllimi i arsimit qytetar duhet të jetë zhvillimi i përgjithshëm i individit dhe lidhja përkatëse mes sistemit dituri-shkathtësi-vlera-sjellje.<sup>23</sup>

Lidhur me librat shkollorë, analiza tregoi se pjesa më e madhe e pyetjeve të ofruara në to, mund të klasifikohen nën dimensionin “dituri” (riprodhim konkret të një informacioni të caktuar që gjendet në tekst), derisa pjesa më e vogël e pyetjeve kanë të bëjnë me zhvillimin e një shkathtësie të caktuar. Lidhur me detyrat e ofruara në librat shkollorë, analiza përcaktoi se ato mundësojnë hapësirë për zhvillimin e mendimit kritik dhe shqyrtimit të ideve dhe pozicioneve dhe ofrojnë qasje konstruktive ndaj nxënies.<sup>24</sup>

Megjithatë, hulumtimi bëri të ditur për ekzistimin e mospërputhjes mes qëllimeve nga programet mësimore dhe detyrat në librat shkollor. Konkretisht, një pjesë e vogël e qëllimeve në program kanë të bëjnë me shkathtësi, derisa pjesa më e madhe e detyrave në librat shkollor kanë për qëllim zhvillimin e shkathtësive. Në mënyrë plotësuese në program janë të përfaqësuara qëllime që kanë të bëjnë me qëndrime dhe vlera, këto aspekte nuk janë të përfshira sa duhet në librat shkollorë.<sup>25</sup>

Duke marrë parasysh parimet e arsimit fillor sipas *Koncepcionit për edukim dhe arsim nëntëvjeçar*, angazhimet për krahasim ndërkombëtar të rezultateve nga nxënia e nxënësve, si edhe praktika përkatëse ndërkombëtare në mësimdhënien e arsimit qytetar, mund të përcaktohet se përvojat ndërkombëtare nuk janë të reflektuara në mënyrë përkatëse në programet mësimore për arsim qytetar të vitit 2008 dhe librat e përdorur shkollor. Kjo veçanërisht ka të bëjë me përfaqësimin e pamjaftueshëm të zhvillimit të shkathtësive për shprehje të argumentuar, analizë kritike të informacioneve, ndërtim të qëndrimeve, si dhe nxitje të nismës dhe aksion në shoqërinë qytetare. Si rrjedhojë, u paraqit **nevoja për rishqyrtimin dhe rishikimin e programeve mësimore të arsimit qytetar të vitit 2008, nga aspekti i përshtatjes së përmbajtjeve dhe qasjeve që përdoren në vende të tjera të Evropës dhe botës.**

### III.3. IMPLEMENTIM I ASPEKTEVE NGA ARSIMI QYTETAR NË LËNDË TË PËRAFËRTA

Në mënyrë që të vlerësohet përfshirja ndërmjet-lëndore e përmbajtjeve dhe metodave që nxisin zhvillim të kompetencave qytetare në lëndë të tjera mësimore, Byroja e Zhvillimit të Arsimit zbatoi analizë të programeve mësimore nga plani mësimor i arsimit fillor nëntëvjeçar. Është analizuar përfaqësimi i qëllimeve, përmbajtjeve dhe aktiviteteve në programet mësimore nga disa lëndë të caktuara mësimore që (në mënyrë të drejtpërdrejt ose tërthortë) kanë të bëjnë me përvetësimin e diturive, shkathtësive dhe/ose ndërtimin e qëndrimeve dhe interesave të nxënësit që kanë të bëjnë me arsimin qytetar.

Analiza i përfshiu programet mësimore nga lëndët mësimore nga fushat shoqërore-humane (shoqëri, histori, njoftim me religjionet, kulturë klasike në qytetërimin evropian, etikë në religjionet) dhe gjuha amtare (gjuhë maqedonase/shqipe/turke/serbe/boshnjake), si dhe programet nga arsimit për shkathtësi

<sup>23</sup> Mickovska Raleva, A. (2016) Civic Education for Democratic Citizens: To What Extent do Civic Education Curricula and Textbooks Establish Foundations for Developing Active Citizens in the Former Yugoslav Republic of Macedonia?, punim i prezantuar në konferencën Politics of Education in Societies in Transition: Interdisciplinary Perspectives, University of Birmingham, Institute of Advanced Studies, July 2017.

<sup>24</sup> Ibid.

<sup>25</sup> Ibid.

jetësore që realizohen në orën klasore. Përfundimet kryesore nga analiza bëjnë të ditur në konstatimet si vijon:

- Temat që i përfshin lënda mësimore **shoqëri** paraqesin bazën e mësimdhënies së arsimit qytetar dhe përfshijnë përmbajtje të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, bashkësinë lokale, grupet dhe rolet shoqërore, etj..
- Programet mësimore nga **historia** nuk përmbajnë qëllime, përmbajtje, nocione dhe aktivitete që mund të ndërliken drejtpërdrejt me konceptet bashkëkohore të arsimit qytetar dhe arritjen e kompetencave për kulturë demokratike dhe qytetari. Programet përfshijnë përmbajtje mësimore që janë pjesërisht të përpiluara ose nga ana tjetër vetë mësimdhënësit duhet t'i përpilojnë në mënyrë që nxënësit të përvetësojnë dituri dhe shkathtësi nga arsimit qytetar.
- Në programet mësimore nga lëndët **gjuhë maqedonase/shqipe/turke/serbe/boshnjake** në masë të caktuar paraqiten qëllime, përmbajtje dhe aktivitete në të cilat janë përfshirë tema nga arsimit qytetar. Këto aspekte paraqiten në kuadër të fushave programore: shprehje dhe krijim, letërsi dhe lektura, si dhe kulturë mediatike. Nga aspekti i përvetësimit të kompetencave qytetare, këto lëndë kanë potencial për të nxitur zhvillimin e shkathtësive e të menduarit kritik, formulimit të mendimeve dhe shprehjes së qëndrimit personal, respektimit të mendimit të tjetrit, etj.
- Në lëndën mësimore **etikë** shumica e qëllimeve dhe përmbajtjeve janë në përputhje me kompetencat qytetare që nxënësit duhet t'i zhvillojnë.
- **Lëndët mësimore zgjedhore: njoftim të religjioneve, kultura klasike e qytetërimit evropian dhe etika e religjioneve**, kanë qëllime dhe përmbajtje që janë në frymën e arsimit qytetar, kanë të bëjnë me njoftimin e të tjerëve, respektimin e diversiteteve, respektim dhe bashkëpunim me të tjerët, përvetësim të shkathtësive për tolerancë dhe mosdiskriminim, dialog, pranimit dhe respektim të sjelljes humane, zhvillimit të personalitetit dhe vlerave të njeriut.
- Në programin për **arsim për shkathtësi jetësore**, thuajse të gjitha temat programore përmbajnë qëllime dhe përmbajtje që duhet të nxisin zhvillimin e kompetencave qytetare. Në mënyrë plotësuese, mund të shqyrtohet vazhdimësia, zgjerimi dhe thellimi i diturive, përvetësimi i shkathtësive dhe ndërtimi i qëndrimeve të nxënësit në përputhje me parimet bashkëkohore të arsimit qytetar.

#### III.4. KLIMË DEMOKRATIKE NË SHKOLLË

Hulumtimet e praktikave demokratike në shkollat bëjnë të ditur se parimet demokratike, ndonëse respektohen parimisht, praktikohen në mënyrë të pamjaftueshme në shkollat në Republikën e Maqedonisë së Veriut.<sup>26</sup> Për shembull, njëri prej parimeve themelore demokratike – shprehja e lirë e qëndrimeve është praktikuar vetëm pjesërisht. Konkretisht, vetëm një e treta e nxënësve konsiderojnë se shpesh kanë mundësinë për të shprehur mendimin personal lidhur me gjëra që do të kishin dashur të ndryshohen në shkollë. Nxënësit zakonisht ndjehen më të lirë për të iniciuar çështje që i interesojnë gjatë orës së kujdestarisë, edhe në nivel të bashkësisë së nxënësve, por kur një çështje/problem i

<sup>26</sup> Youth Ethnic Integration project. (2018). Baseline Assessment of Schools involved in Year 1 of Project Implementation (2018). Internal project report (raport i papublikuar).

E. S. Markovska, M. Nashokovska dhe T.G. Ajanovska (2010). *Analizë e zbatimit e të drejtave të fëmijës në Republikën e Maqedonisë (shqyrtim të veçantë në pjesëmarrjen, të drejtën e bashkimit dhe të drejtën e arsimit)* Prilep: Koalicion i organizatave rinore „SEGA“.

E. S. Markovska dhe M. Nashokovska (2014). *Rezultate nga monitorimi mbi zbatimin e Konventës së të drejtave të fëmijës në Republikë e Maqedonisë për vitin 2013*. Prilep: Koalicion i organizatave rinore „SEGA“.

caktuar duhet të iniciohet në nivel më të lartë, ata përballen me mungesë të diturisë, shkathtësive, si dhe procedurave formale për veprim.<sup>27</sup>

Lidhur me mundësitë që nxënësit i kanë për pjesëmarrje dhe ndikim gjatë marrjes së vendimeve për gjëra që kanë të bëjnë me ta/i interesojnë ata, rreth gjysma e nxënësve të anketuar janë përgjigjur se shpesh ose ndonjëherë mund të marrin pjesë, derisa të tjerët konsiderojnë se rrallë ose asnjëherë nuk e kanë mundësinë e tillë. Megjithatë, analiza cilësore bën të ditur për një pasqyrë më të ndryshme, sipas të cilës shumica e nxënësve (veçanërisht nga shkollat fillore) bëjnë të ditur se rrallë kanë mundësi për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes në shkollë, ndonëse të gjithë do të donin të kenë një mundësi të tillë. Situatat kur nxënësit përfshihen në këto procese në të shumtën e rasteve kanë të bëjnë me vendime më pak të rëndësishme, si p.sh. për ekskursionë, uniforma të shkollës, mbrëmje të (gjysmë) maturës dhe më rrallë – pamja e klasës.<sup>28</sup>

Në përgjithësi, besimi i nxënësve se ata mund të nxisin ndryshime pozitive në bashkësi është në nivel të ulët. Çdo i dyti nxënës konsideron se nxënësit mund të ndikojnë në iniciimin e ndryshimit në shkollë, derisa çdo i treti konsideron se mund të ndikojnë në ndryshimin e nivelit të komunës. Gjetje cilësore bëjnë të ditur se nxënësit në fakt nuk dinë se si të kërkojnë dhe iniciojnë një ndryshim të caktuar dhe se u mungon sistematikë dhe qëndrueshmëri në kërkesat.<sup>29</sup>

Është inkurajuese e dhëna se shumica e nxënësve konsiderojnë se kanë përgjegjësi që të aktivizohen për t'i adresuar nevojat në mjedisin e tyre, si dhe se kanë fuqi për të bërë ndryshim në shkollë. Megjithatë, është brengosës fakti që thuhet gjysma konsiderojnë se nëse i shprehin haptazi mendimet e tyre do të mund të kenë probleme në shkollë. Kjo bën të ditur se nxënësit ndonëse janë të vetëdijshëm për atë se si do të duhej të ishin gjërat, njëherësh janë të penguar nga ajo se si janë ato në realitet. Konflikti i këtyllë i qëndrimeve tregon se ka hapësirë të madhe për intervenim në aspektin e promovimit të nxënësve si faktorë aktiv në shkollë dhe bashkësi, përmes sensibilizimit të shkollave për proceset e pjesëmarrjes së nxënësve dhe përfshirjes së nxënësve në iniciativa konkrete të nxënësve, të orientuara drejt ndryshimeve pozitive në mjedis.

Megjithatë, tregohet se intervenime më afatgjata që përfshijnë mbështetje të pjesëmarrjes së nxënësve japin rezultate pozitive në drejtim të diturisë së përmirësuar për të drejtat e fëmijëve dhe ndikim të rritur të organizimit të nxënësve në proceset e vendimmarrjes.<sup>30</sup>

#### IV. KOMPETENCA QYTETARE NË SISTEMIN ARSIMOR TË MAQEDONISË

Në vitin 2017, për avancimin e mësimin të arsimit qytetar në arsimin fillor dhe të mesëm, një ekip profesionalpërpiloi dokument për kompetenca qytetare. Baza e dokumentit janë kompetencat qytetare të përfshira në letërsinë profesionale dhe dokumentet ndërkombëtare<sup>31</sup>, por edhe situatat me arsimin qytetar në shkollat tona dhe sfidat me të cilat përballen demokracia në zhvillimin e shoqërisë multietnike dhe multikulturore të Maqedonisë.

<sup>27</sup> Youth Ethnic Integration project. (2018). Baseline Assessment of Schools involved in Year 1 of Project Implementation (2018). Internal project report (raport i papublikuar).

<sup>28</sup> Ibid.

<sup>29</sup> Ibid.

<sup>30</sup> Project "Implementation of Convention on the rights of the child in Macedonia" (2011 – 2019). Comparative students' survey assessments in 2018 and 2019 in (30) schools involved in the project. Internal project report (raport i papublikuar).

<sup>31</sup> P.sh.. Torney-Purta, J., & Lopez, S. V. (2006). *Developing Citizenship Competencies from Kindergarten Through Grade 12: A Background Paper for Policymakers and Educators*. Education Commission of the States (NJ3). Brammer, L., Dumlaio, R., Falk, A., Hollander, E., Knutson, E., Poehnert, J., ... & Werner, V. (2012). *Core competencies in civic engagement [a working paper in the Center For Engaged Democracy's policy papers series]*. The Center for Engaged Democracy Core Competencies Committee. North Andover, MA: Merrimack College. Council of Europe. (2018). *Reference Framework of Competences for Democratic Culture. Volume 3 : Guidance for implementation*. Council of Europe.

Lista e kompetencave është zhvilluar në bazë të premisë se arsimi ka rol të rëndësishëm në përgatitjen e nxënësve për të jetuar si qytetarë demokratik dhe aktiv që do të kontribuojnë për zhvillimin e bashkësisë, dhe do të jenë individë kompetentë të aftë për të bërë përzgjedhje të informuara për zhvillimin personal, ose, më konkretisht qytetarë që a) do të posedojnë dituri dhe shkathtësi për të marrë pjesë në jetën qytetare, b) do të duan të jenë të përfshirë në aktivitetet qytetare dhe t'i praktikojnë të drejtat qytetare dhe c) do të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në rrethin lokal, shtetëror, ndërkombëtar dhe digjital.<sup>32</sup>

Në modelin e kompetencave qytetare ata janë të grupuar si:

- a) dituri dhe mirëkuptime;
- b) shkathtësi (shkathtësi kognitive dhe shkathtësi për pjesëmarrje qytetare);
- c) qëndrime dhe vlera;
- ç) sjellje qytetare (angazhim qytetar që përfshin zbatimin e shkathtësive për zgjidhjen e problemeve publike).

Natyra zhvillimore e kompetencave është e arsyetuar qartë përmes niveleve të kompetencave që pritet nxënësit t'i kenë në fund të çdo cikli arsimor në strukturën ekzistuese të arsimit të detyrueshëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut: cikli I, II dhe III i arsimit fillor dhe fundi i arsimit të mesëm. Megjithatë, lista e propozuar të kompetencave më shumë duhet të shikohet si në minimum i kompetencave qytetare që pritet nxënësit t'i marrin gjatë shkollimit formal.

Grupimi i këtyre ka për qëllim që të ndihmojë kryesisht gjatë përpilimit të programeve mësimore dhe mundësimin që të njëjtat t'i përfshijnë të tri dimensionet e nxënies: (a) kognitive – përvetësim të diturive, mirëkuptim të mendimit kritik për vetveten, për njerëzit tjerë, bashkësitë dhe lidhshmërinë e tyre, (b) socio-emocionale – zhvillim të ndjenjës së përkatësisë ndaj bashkësisë së njerëzve që ndajnë të drejta, përgjegjësi, vlera, ndjeshmëri, solidaritet dhe respektim të dallimeve dhe c) praktike – të veprohet në mënyrë aktive në nivel lokal, kombëtar dhe global në botë në të cilën do të sundojë paqe dhe do t'i kushtohet kujdes zhvillimit të qëndrueshëm të saj.

Duke i marrë parasysh dokumentet e ndryshme, e kryesisht kontekstin e Maqedonisë (programet dhe projektet e deritanishme mësimore për arsim qytetar) edhe nevoja e avancimit të përmbajtjeve që mësohen, kompetencat janë të grupuara në fushat vijuese të përmbajtjeve:

### 1. Identitet qytetar – Pasqyrë për veten si qytetar

Vetëdije për identitetin personal  
Dallim dhe zhvillim të veçorive personale  
Kontroll i sjelljes  
Shprehje e emocioneve  
Etikë  
Planifikim i zhvillimit profesional dhe në karrierë

### 2. Lidhshmëri qytetare

Pranim dhe respektim i diversiteteve  
Shqyrtim i këndvështrimeve të ndryshme  
Komunikim  
Përballje me konflikte  
Përkatësi ndaj bashkësisë  
Empati dhe humanitet  
Multikulturalizëm dhe jetesë e integruar

<sup>32</sup> Torney-Purta, J., & Lopez, S. V. (2006). *Developing Citizenship Competencies from Kindergarten Through Grade 12: A Background Paper for Policymakers and Educators*. Education Commission of the States (NJ3).



### 3. Qytetarë në shoqëri qytetare

Roli i qytetarit në shoqëri  
 Të drejta dhe përgjegjësi  
 Qytetari dhe zhvillimi i qëndrueshëm  
 Qytetari si novator dhe sipërmarrës  
 Qytetari si konsumator  
 Qytetari si kursimtar  
 Organizatat qytetare dhe grupet e përfaqësimit  
 Mediat në shoqërinë demokratike  
 Religjion në shoqëri  
 Arti, kultura, institucionet kulturore dhe identiteti kulturor

### 4. Qytetari dhe shteti

Pushtet në funksion të qytetarëve  
 Si është organizuar pushteti në Republikën e Maqedonisë së Veriut  
 Sundimi i së drejtës  
 Zgjedhjet dhe proceset demokratike në shoqëri  
 Roli shoqëror i shtetit dhe administratës publike  
 Financim i institucioneve shtetërore dhe publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut

### 5. Qytetari dhe bota

Republika e Maqedonisë së Veriut në raport me Bashkimin Evropian (BE) dhe Këshillin e Evropës (KE)  
 Republika e Maqedonisë së Veriut pjesë e Evropës  
 Republika e Maqedonisë së Veriut në organizatat ndërkombëtare

Dokumenti është i dedikuar kryesisht që të shërbejë gjatë përpilimit të planeve dhe programeve për arsim qytetar, si për lëndët mësimore ashtu edhe për aktivitetet jashtëshkollore. Krahas kësaj, kompetencat mund të jenë bazë për përpilimin e kornizës për matjen shtetërore e të arriturave në arsimin qytetar. Ato mund të ndihmojnë edhe gjatë përpilimit të librave shkollorë dhe të doracakëve për mësimdhënës për zhvillimin e kompetencave qytetare, gjegjësisht gjatë përkufizimit të standardeve për libër shkollor nga arsimit qytetar dhe përkufizimi i treguesve për vlerësimin e librave shkollorë dhe mjeteve të tjera didaktike për lëndën mësimore arsim qytetar.

Në vitin 2019, si pjesë e implementimit të *Strategjisë së arsimit për vitin 2018-2025* u përpiluan standardet kombëtare e të arriturave, që janë përkufizuar për tetë fusha: arsimim gjuhësor, mësim të gjuhëve të tjera, matematikë, shkenca natyrore dhe teknologji, arsimim digjital, zhvillim personal dhe social, **kulturë demokratike dhe qytetari**, sipërmarrësi dhe arsimim financiar, si dhe shprehje artistike, kulturë dhe multikulturë. Standardet janë prezantuar si përshkrime të kompetencave në fushën e dhënë që nxënësit duhet t'i arrijnë në fund të arsimit fillor. Kompetencat e përshkruara në dokumentin për kompetenca qytetare paraqesin bazë për zhvillimin e standardeve të arritjeve në fushën "Kulturë demokratike dhe qytetari".<sup>33</sup> Si rrjedhojë, këtu bëjnë pjesë kompetencat që kanë të bëjnë me dituritë dhe mirëkuptimin e individit për vetveten, për shoqërinë dhe organizimin e saj, për konceptet ekonomike dhe politike, strukturat dhe lëvizjet, si dhe të shkathtësive dhe qëndrimeve që duhet t'i mundësojnë që të sillen si qytetar/qytetare i/e përgjegjshëm/përgjegjshme dhe të marrë pjesë në mënyrë të motivuar dhe aktive në jetën shoqërore dhe qytetare.<sup>34</sup>

<sup>33</sup> Në tekstin e mëtejshëm të dokumentit, termet „kompetenca qytetare“ dhe „kompetenca për kulturë demokratike dhe qytetari“ do të përdoren në mënyrë vijuese.

<sup>34</sup> Byroja për Zhvillimin e Arsimit. (2020) Standarde kombëtare për arsim fillor, versioni punues.

## V. KONCEPT I RI I ARSIMIT QYTETAR. FORMAT E ZBATIMIT

Duke marrë parasysh përfaqësimin dhe mësimin e arsimit qytetar në sistemet arsimore evropiane, dokumentet e miratuara nga Këshilli i Evropës, si dhe udhëzimet që i japin *Standardet e reja kombëtare të mbështetura në kompetenca për nxënie të përjetshme*, ndërsa të përkufizuara me *Ligjin e ri të arsimit fillor*, koncepti i ri i arsimit qytetar është i orientuar drejt implementimit të të gjitha përvojave pozitive dhe drejt arritjes së standardeve deri në fund të arsimit fillor.

Kompetencat e përpiluara qytetare paraqesin bazën për standardet në fushën *Kulturë demokratike dhe qytetari*, ndërsa përmes tyre – në programet mësimore dhe në aktivitetet jashtëshkollore dhe programet tjera të shkollës.

Si rrjedhojë, koncepti i ri i përfshin mënyrat e ndryshme të arsimit qytetar përmes:

- lëndës së detyrueshme mësimore;
- vendosjes së qëllimeve dhe përmbajtjeve në disa lëndë të caktuara mësimore; dhe
- aktiviteteve jashtëshkollore.

Qasja zhvillimore e konceptit të ri parashikon që kompetencat për kulturë demokratike dhe qytetari nxënësit t'i zhvillojnë që para ciklit të parë arsimor, gjegjësisht nga klasa e parë deri në të tretën, përmes qasjes së integruar, përmes lëndëve mësimore që nxënësit i kanë në planin mësimor, si dhe përmes aktiviteteve jashtëshkollore. Mënyra e njëjtë vazhdon edhe në ciklin e dytë, gjegjësisht nga klasa e katërt deri në klasën e gjashtë, derisa në ciklin e tretë arsimor, krahas integritimit në tema nga arsimit qytetar në lëndë të ndryshme mësimore dhe përmes aktiviteteve jashtëshkollore (klubet e ndryshme, aksionet dhe organizatat shkollore në kuadër të shkollës), nxënësit mësojnë edhe lëndë të posaçme të detyrueshme mësimore – arsim qytetar.

### V.1. LËNDË MËSIMORE ARSIM QYTETAR

Si pjesë e konceptit të ri për arsim qytetar janë përpiluar dy programe të reja mësimore në arsimin fillor nga lënda mësimore arsim qytetar për klasën e VIII-të dhe IX-të (që zbatohen prej vitit shkollor 2018/2019 gjegjësisht vitit shkollor 2019/2020). Programet mësimore nga lënda arsim qytetar i ndjekin qasjet botërore dhe evropiane në arsimin drejt zhvillimit të kompetencave për të funksionuar si pjesëmarrës demokratik dhe aktiv në shoqërinë qytetare. Ato janë të përpiluara në përputhje me kompetencat për periudhën e tretë zhvillimore (klasa VII-IX), me rezultate të përcaktuara qartë nga nxënia, gjegjësisht çfarë është ajo për çka do të ishte i aftë nxënësi pas realizimit të programit.

Qëllimet zhvillimore, qëllimet e përgjithshme, përmbajtjet, aktivitetet dhe rezultatet nga nxënia nga programet mësimore përfshijnë kompetenca personale, interpersonale dhe interkulturore për nxënësit që i përfshijnë të gjitha llojet e sjelljes që u siguron individëve të marrin pjesë në jetën shoqërore dhe punë, veçanërisht në shoqëritë me diversitete, drejt zvogëlimit të konflikteve dhe zgjidhjes së të njëjtave.

Aktivitetet e propozuara në programin mësimor përfshijnë metoda për avancimin e pjesëmarrjes aktive të nxënësve në shkollat dhe proceset e vendimmarrjes për bashkësinë, me çka nxënësit përgatiten për jetë të përgjegjshme në një shoqëri demokratike qytetare.

Programin mësimor për klasën e VIII-të është strukturuar ashtu që ofron gjashtë tema të integruara mes vete dhe të njëjtat, në përputhje me parimin e spirales në përpilimin e programit, zhvillohen edhe në klasën e IX-të. Zhvillimi në programet shihet në rezultatet e pritura që janë vendosur “pak mbi” diturinë ekzistuese, në mënyrë që të vepohet në mënyrë inkurajuese, motivuese dhe të rritet vetëbesimi te nxënësit.

**Tema mësimore në programin mësimor nga arsimit qytetar:**

Tema mësimore klasa e VIII-të	Tema mësimore klasa e IX-të
Tema I: Pasqyrë për veten si qytetar	Tema I: Identitet qytetar
Tema II: Bashkëpunim dhe lidhshmëri në shoqërinë qytetare	Tema II: Bashkëpunim dhe lidhshmëri në shoqërinë qytetare
Tema III: Qytetari dhe shoqëria	Tema III: Qytetari në shoqërinë qytetare
Tema IV: Religjioni, arti dhe mediat në shoqërinë qytetare	Tema IV: Kultura, identiteti kulturor, religjioni dhe mediat sociale
Tema V: Qytetari dhe shteti	Tema V: Qytetari dhe shteti
Tema VI: Qytetari dhe bota	Tema VI: Qytetari dhe Evropa

Një pjesë e konsiderueshme e qëllimeve të programit mësimor kanë të bëjnë me zhvillimin e individit dhe vlerave themelore të njeriut, lirinë individuale, integritetin, dinjitetin dhe të drejtat e barabarta, forcimin e ndjenjës së drejtësisë, tolerancës dhe përgjegjësisë, si dhe me përgatitjen e nxënësve për jetë të përgjegjshme në shoqëri demokratike qytetare. Në mënyrë që ato të arrihen, është e domosdoshme që të krijohen situata mësimore që përfshijnë diskutimin, nxitjen e të menduarit kritik, argumentimin dhe vetëreflektimin.

Mësimdhënësit e arsimit qytetar planifikimet dhe përgatitjet e tyre për mësim duhet t'i zhvillojnë në bazë të qëllimeve dhe rezultateve nga nxënia sipas temave dhe përmbajtjeve mësimore, me përzgjedhjen përkatëse të metodave dhe aktiviteteve në procesin mësimor. Planifikimi përfshinë detyra që duhet të kryhen në kohë të caktuar në mënyrë që të arrihen qëllimet e vendosura dhe rezultatet nga nxënia, por edhe mënyrat e ndjekjes dhe vlerësimit të rezultateve të arritura. Pika nismëtare për përpilimin e planifikimit, krahas rezultateve të pritura, është reflektim për të arriturat paraprake të nxënësve dhe efektivitetin e qasjeve të zbatuara mësimore. Në bazë të rezultateve të qarta nga nxënia që janë vendosur në programet mësimore, mësimdhënësit mund të përpilojnë edhe kritere për notimin e nxënësve.

Programi mësimor parashikon ndjekjen e rregullt dhe vlerësimin e të arriturave të nxënësve. Për arritjen e rezultateve të pritura konstatohet me krahasimin e nivelit të përparimit të nxënësit me rezultatet e pritura, e në bazë të ndjekjes paraprake formative dhe notimit të nxënësve. Krahas kësaj, ndiqen edhe aktivitetet për ndërtimin e qëndrimeve dhe mendimeve të tyre për çështje të caktuara nga materiali mësimor, motivimi për nxënie, bashkëpunimi me të tjerët, angazhimi i nxënësve në bashkësinë. Për gjithë këtë nxënësit marrin informacione kthyesë dhe udhëzime për përmirësimin e punës dhe të arriturave të tyre.

Nga mjetet mësimore didaktike dhe mjeteve ndihmëse të rekomanduara për realizimin e mësimin nga lëndët e përmendura mësimore janë: libri shkollor për klasën përkatëse i aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, burimet tjera të nxënies në mjedisin e drejtpërdrejt, doracakët për mësimdhënës dhe udhëzuesit për nxënës të përpiluar nga Byroja e Zhvillimit të Arsimit, enciklopeditë, fjalorët, revistat, shtypi ditor, aktet ligjore, dokumentet ndërkombëtare; përmbajtjet nga interneti, softuerët arsimorë dhe përmbajtjet digjitale: mjetet audio-vizuale dhe mjetet tjera përkatëse për lëndën.

Mësimi nga arsimit qytetar veçanërisht duhet të kontribuojë në pjesëmarrjen e nxënësve në shkollë dhe bashkësi dhe formimin e qëndrimit pozitiv ndaj qytetarisë aktive. Nxënësit duhet të jenë të inkurajuar për të nxjerrë ide për përmirësimin e klimës në shkollë dhe bashkësi, të planifikojnë probleme dhe sfida

që mund të zgjidhen me aktivitete, nisma, vullnetarizëm, të propozojnë nisma të nxënësve dhe qytetarëve dhe t'i realizojnë ato. Në këtë mënyrë do të kontribuojnë në zhvillimin e bashkësisë, do ta forcojnë vetëbesimin dhe do të bëhen kompetentë për të bërë ndryshim pozitiv në jetën personale dhe në bashkësi.

## V.2. PËRFSHIRJA E KOMPETENCAVE QYTETARE NË LËNDË TË TJERA

Duke marrë parasysh natyrën interdisiplinore të arsimit qytetar, si fushë, ekziston pajtueshmëri e përgjithshme se kompetencat qytetare duhet të jenë të përfshira si qëllim transversal<sup>35</sup> në lëndët e ndryshme mësimore. Si rrjedhojë, zhvillimi i përgjithshëm i këtyre kompetencave nënkupton përfshirjen e tyre në të a.q. lëndë “tradicionale”. Kur arsimi qytetar trajtohet si temë ndërmjet-lëndore, të gjithë mësimdhënësit duhet të kontribuojnë drejt arritjes së qëllimeve që janë të përkufizuara në politikat kombëtare.

Përvetësimi i kompetencave qytetare mund të kontribuojë në zhvillimin e potencialit inovativ dhe kreativ të nxënësve. Sukses i përvetësimit të kompetencave qytetare përmes lëndëve të ndryshme mësimore, me ç'rast merret parasysh zhvillimi i shkathtësive, qëndrimeve, vlerave, sjellja qytetare dhe të kuptuarit kritik për kulturë demokratike dhe qytetari, varet nga ajo se sa mirë mësimdhënësit dinë të planifikojnë dhe realizojnë aktivitete përkatëse dhe t'i përshtatin sipas nevojave të tyre dhe nevojave të nxënësve. Në lëndët nga fusha shoqërore-humanitare dhe fusha gjuhësore në kuadër të programeve ekzistuese mësimore, mund të planifikohen dhe realizohen relativisht mirë aktivitete për nxënien e vlerave, qëndrimeve, shkathtësive dhe diturive dhe të kuptuarit kritik që u nevojiten nxënësve që të mund të kontribuojnë në bashkësinë dhe shoqërinë qytetare në interes të së mirës së përbashkët. Megjithatë, edhe lëndët tjera japin mundësi për arritjen e kompetencave të caktuara qytetare, veçanërisht në fushën e shkathtësive dhe vlerave.

### Shembulli 2. Përvetësim i kompetencave qytetare përmes mëimit nga kimia

Gjatë planifikimit të njëjës prej orëve në të cilat do të mësohet përmbajtja mësimore “Karburante fosile dhe ato alternative”, mësimdhënësi parashikon përvetësim dhe zhvillim të kompetencave qytetare si vijon: shkathtësi për dëgjim aktiv, analizë kritike dhe diskutim për role dhe sjellje të ndryshme të qytetarët në jetën e përditshme; qëndrimi se mbrojtja dhe avancimi i mjedisit jetësor është i rëndësishëm për mirëqenien e qytetarëve; dhe sjellje që përfshin inicimin dhe përfshirjen në aktivitete për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të bashkësisë. Në mënyrë që të integrohen kompetencat qytetare me dituritë e nxënësve për përmbajtjet e lëndës, mësimdhënësi në përgatitjen ditore ka planifikuar përdorimin e diskutimit, debatit, punës në çifte dhe grupe.

Si aktivitet i parë, mësimdhënësi dhe nxënësit diskutojnë për cilësinë e ajrit në qytetin e tyre dhe rëndësinë e tij, me ç'rast mësimdhënësi i udhëzon nxënësit që t'i analizojnë në mënyrë kritike të dhënat më të reja për ndotjen e ajrit nga hulumtimet e Agjencisë Evropiane të Mjedisit Jetësor dhe kontributit të faktorëve të ndryshëm në ndotjen, me fokus në karburantet.

Në pjesën kryesore të orës realizohet debat në të cilën të dy ekipet e nxënësve, përgatisin argumente dhe debatojnë për dhe kundër përdorimit të karburanteve fosile. Grupi i tretë i nxënësve marrin pjesë në aktivitetin si gjykatës, me ç'rast duhet ta vlerësojnë cilësinë e argumenteve, si dhe sjelljen e nxënësve-debatues. Pas debatit nxënësit bisedojnë për aktivitete të mundshme për informim dhe nxitje të qytetarëve për sjellje më të qëndrueshme lidhur me përdorimin e karburanteve.

Në fund të orës, mësimdhënësi zbaton një aktivitet vlerësues-refleksiv, me ç'rast i udhëzon nxënësit të mendojnë për dituritë dhe shkathtësitë e sapo përvetësuara vlerësuese, rrjedhën e debatit, si dhe

<sup>35</sup> Kompetenca të tjera të tilla transversale janë: digjitale, sipërmarrëse dhe metakognitive („nxënia si të mësohet“).

dhënjën e mendimit të tyre personal për ndërmarrjen e veprimeve në nivel individual për dhënien e kontributit në përmirësimin e cilësisë së ajrit.

### V.3. AKTIVITETE JASHTËSHKOLLORE

Aktivitetet jashtëshkollore, sipas rregullës, realizohen në mjedis të relaksuar dhe jashtë rrethimit formal, për shkak të cilës arsye mundësojnë përvetësimin e kompetencave të cilave zakonisht nuk u kushtohet vëmendje e mjaftueshme gjatë mësimit të rregullt.<sup>36</sup> Ato janë veçanërisht të përshtatshme për arritjen e qëllimeve edukuese të arsimit, që kanë të bëjnë me formimin e karakterit, gjegjësisht miratimin e vlerave, ndërtimin e qëndrimeve, formësimin e një lloji të caktuar të sjelljes pozitive, socializimin, që në vete përfshin ndjenjën e ndjeshmërisë, demonstrimin e mirëkuptimit dhe respektimin e të gjithë njerëzve.

Në mënyrë plotësuese, aktivitetet jashtëshkollore, në të cilat nxënësit përfshihen sipas interesave, e shpeshherë edhe aftësive/talenteve të posaçme, mundësojnë nxitjen e kreativitetit dhe të menduarit kritik të nxënësit, vetorganizimin dhe përzgjedhjen e përmbajtjeve për të cilat janë të interesuar, përfshirje në aktivitete për përmirësimin e jetës në shkollë dhe bashkësi, që janë kompetenca të rëndësishme për një qytetari demokratike. Në fakt, kompetencat për kulturë dhe qytetari demokratike që mund të realizohen më vështirë përmes programeve mësimore duhet të realizohen përmes formave të ndryshme të aktiviteteve jashtëshkollore, duke përfshirë edhe përmes organizimit të nxënësve në organizata të nxënësve.

Në përputhje me *Koncepcionin për aktivitete jashtëshkollore* nga Byroja e Zhvillimit të Arsimit, në shkolla mund të formohen edhe klube për mbështetjen e zhvillimit personal dhe social të nxënësve, gjegjësisht: multikulturë, shkathtësi komunikuese, zgjidhje të konflikteve, respektim të diversiteteve, debatim, të drejta të fëmijës/njeriut, me çka krijohen mundësi për zhvillimin e kompetencave qytetare. Edhe llojet tjera të aktiviteteve jashtëshkollore që në bazë të përmbajtjes nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me kompetencat qytetare, me parimet e organizimit dhe realizimit mundësojnë zhvillim dhe praktikim të kompetencave të tilla.

Ajo që është e rëndësishme për aktivitetet jashtëshkollore është që ato të organizohen dhe udhëhiqen sipas parimeve të: inkluzivitetit dhe mosdiskriminimit; pjesëmarrjes aktive të nxënësve; tërheqëse për nxënësit; kontributit drejt zhvillimit kognitiv, socio-emocional dhe psikomotorik të nxënësve; dhe kur ka mundësi – nxitjes së bashkëpunimit mes shkollës dhe bashkësisë më të gjerë, dhe integrimi ndëretnik në arsimin.<sup>37</sup>

Shembull i aktiviteteve jashtëshkollore baza themelore e të cilave është zhvillimi i kompetencave për kulturë dhe qytetari demokratike janë **aksionet në shkollë dhe bashkësi**, si dhe **aktivitetet që përfshijnë organizim të nxënësve**. Të parat në të shumtën e rasteve realizohen brenda një dite, por mund të zgjasin edhe disa ditë. Mund të jenë të karakterit shoqëror, humanitar ose ndonjë karakteri tjetër, siç janë, për shembull, aksione të ndryshme ekologjike, aksione humanitare, bazare për shitje, aktivitete vullnetare dhe ndonjë lloj tjetër i punës së dobishme shoqërore. Të dytat, krahas nxitjes së participimit demokratik të nxënësve, përmes zbatimit të **nismave të nxënësve** mundësojnë trupa të nxënësve të iniciojnë aksione të ndryshme për vendosjen e ndryshimeve në paralelen e tyre ose në shkollë.<sup>38</sup>

### V.4. METODA MËSIMORE PËR ZHVILLIMIN E KOMPETENCAVE QYTETARE

Qasjet që përdoren në realizimin e mësimit dhe aktiviteteve jashtëshkollore dhe atmosfera që krijohet përmes përdorimit të tyre janë kyçe për zhvillimin e kompetencave qytetare. Ato zhvillohen në mënyrë

<sup>36</sup> Keser, F., Akar, H., & Yildirim, A. (2011). *The role of extracurricular activities in active citizenship education*. Journal of curriculum studies, 43(6), 809-837.

<sup>37</sup> Byroja për Zhvillimin e Arsimit. (2020). *Koncepcion për aktivitete jashtëmësimore*.

<sup>38</sup> Ibid.

më adekuate përmes praktikimit të tyre nëpër aktivitete më të ndryshme mësimore dhe jashtëshkollore. Si rrjedhojë, zbatimi vetëm i metodave tradicionale të punës, mund të jetë në kundërshtim me zhvillimin e kompetencave qytetare.

Nga ana tjetër, përdorimi i metodave bashkëkohore të mësimin dhe nxënies aktive, pa dallim të lëndës mësimore në të cilën zbatohen, krijon shumë mundësi për zhvillimin e kompetencave qytetare. Disa nga këto metoda janë përshkruar më poshtë.

#### V.4.1. NXËNIE PËRMES PROJEKTEVE

Në nxënien përmes projekteve nxënësit mund të hulumtojnë çështje ose probleme të ndërlikuara nga jeta reale që kanë të bëjnë me përmbajtjet nga programi mësimor me ndihmën e veprimeve për zgjidhjen e problemeve dhe shfrytëzimin e burimeve të ndryshme të nxënies dhe materialeve, në mënyrë që të merret përgjigje ndaj pyetjeve të parashtruara fillimisht ose që të zgjidhet problemi.

Kjo mënyrë e nxënies kontribuon në përvetësimin e kompetencave qytetare përmes zhvillimit të shkathtësive për përdorimin e resurseve të ndryshme, grumbullim, klasifikim dhe prezantim të të dhënave, lidhshmëri të diturive nga fusha dhe lëndë të ndryshme. Përmes projekteve mundësohet që nxënësit në mënyrë të mëvetësishme ose duke punuar në çifte dhe grupe të vijnë deri te njohuritë për një temë të caktuar dhe **të nxjerrin konkluzione dhe të marrin vendime që mbështeten në fakte**.

Gjatë punës në projekte mësimdhënësi i përmendë nxënësit në gjetjen dhe shfrytëzimin e resurseve, e ndjekë punën dhe sipas nevojës e orienton, e ndjekë dhe e vlerëson përparimin. Megjithatë, pjesë kyçe e nxënies përmes projekteve është **hulumtimi i mëvetësishëm**, ku nxënësit në mënyrë individuale ose në grupe përdorin materiale dhe pavarësisht nga mësimdhënësi gjejnë të dhëna të nevojshme për të zgjidhur një problem të caktuar. Ndonjëherë hulumtimet mund të jenë pjesë e ndonjë projekti më të madh dhe të përfshijnë grup më të madh të nxënësve ose gjithë paralelen.

Kjo metodë e nxënies dhe mësimdhënies u mundëson nxënësve liri dhe mëvetësi në marrjen e vendimeve (për përzgjedhjen e problemit, mënyrës së punës, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve gjatë punës në grup, etj.), që rezultojnë me shkathtësi të zhvilluara për marrjen e vendimeve dhe mendim kritik. Për zhvillimin e kompetencave qytetare potencial të veçantë ka faza e prezantimit të njohurive dhe zgjidhjeve gjatë së cilës nxënësit praktikojnë shkathtësi për argumentim, ndërmarrje të nismave dhe e zhvillojnë kompetencën e tyre për aksion.

Projektet mund të jenë pjesë e mësimdhënies së përmbajtjes mësimore, por, gjithashtu, mund të paraqesin mënyrë të përpunimit dhe ndërmarrjes së aksioneve për tema që janë me rëndësi të madhe për shëndetin, mjedisin jetësor, bashkësinë, si dhe për tema të ndjeshme, siç janë sjelljet e rrezikshme, dhuna, etj. Shembulli për integrim të nxënies përmes projekteve, në kuadër të lëndëve të ndryshme është paraqitur më poshtë.

#### Shembulli 3. Nxënie përmes projekteve në Andorë

Në Andorë, në vitet e para të arsimit të mesëm (nxënës të moshës 12 dhe 13 vjeç), programi mësimor për tërë shkollën është organizuar rreth dy projekteve globale. Projekti i parë parashtron një problem shoqëror, ndërsa i dyti parashtron problem nga shkencat natyrore. Përmbajtjet e të gjitha lëndëve nga programi i parashikuar mësimor janë përzgjedhur në mënyrë që ndihmon në zgjidhjen e këtyre problemeve sociale dhe natyrore. Secili projekt zhvillohet në mënyrë javore, në sesione nga dy orë në fillim dhe tre orë në fund të javës. Puna metodologjike e këtyre projekteve gjithmonë është në bashkëpunim me nxënësit. Të gjitha projektet ndahen me të gjitha klasat në shkollë, po madje edhe me bashkësinë lokale. Secili projekt zgjatë katër ose pesë javë, kështu që gjatë vitit shkollor ka gjashtë projekte globale sociale dhe gjashtë projekte globale natyrore. Shembull për një projekt shoqëror është: sfidat e shoqërive multikulturale, ndërsa shembull për projekt global nga shkencat natyrore është: ndikimi i njerëzve në ekosistemet. Kompetencat për kulturë demokratike janë integruar në secilin projekt global dhe në metodologjinë e nxënies dhe mësimin.

Huazuar nga: Council of Europe. (2018). Reference Framework of Competences for Democratic Culture. Volume 3: Guidance for implementation. Council of Europe. Mund ta gjeni në: <http://democraticschools.mk/web/wp-content/uploads/2019/06/KNIGA-3-Referentna-ramka-KOMPETENCII-ZA-Demokratska-kultura-za-WEB.pdf>

#### V.4.2. NXËNIE PËRMES ZGJIDHJES SË PROBLEMIT

Nxënia përmes zgjidhjes së problemeve është metodë e punës që në esencë është e ngjashme me nxënien përmes projekteve, por dallon sipas asaj se ka strukturë të përkufizuar më rreptësisht: fillon me identifikimin dhe prezantimin e problemit, vijon përkufizimi/formulimi i problemit, zhvillimi i inventarit të diturive (çfarë dimë për problemin/çfarë duhet të dimë), zhvillim të zgjidhjeve të mundshme, zhvillim të çështjeve për nxënie dhe mentorim të vetorientuar, shpërndarje të gjetjeve dhe zgjidhjeve.

Nxënia përmes zgjidhjes së problemeve duhet të rezultojë me aksion konkret për tejkalimin e problemit. Nxënësit punojnë në ekipe me ç'rast hulumtojnë çështje ose probleme të ndërlukuara nga jeta reale në mënyrë që të ndërmarrin aksion për tejkalimin e një problemi dhe/ose ndryshim pozitiv. Si pjesë finale e projektit nxënësit ndërmarrin aksione për përmirësimin e jetës dhe kushteve në shkollë dhe rrethinën e tyre.

Kjo metodë mund të zbatohet në të gjitha lëndët mësimore. Duke përdorur këtë qasje në mësimin përmirësohet puna e përbashkët dhe shkathtësitë për komunikim, nxitet të menduarit kritik, marrja e vendimeve, zgjidhja e problemeve, mësohet se si të mësojë. Zhvillohen veçoritë personale: përgjegjësi, vetëbesim, vetërespektim, socializim, vetorganizim. Gjithashtu, zhvillohen shkathtësi për organizim, seleksionim, aftësi dhe motivim për aksion si kompetenca të rëndësishme për **ndërmarrjen e aksioneve shoqërore**.

Ndryshimi, gjegjësisht aksioni duhet të kontribuojë për përmirësimin e situatave që janë të lidhura me temën e zgjedhur. Aksioni mund të nënkuptojë rregullimin e klasës, oborrit, organizim të garës, takim, përpunim të informatorit, fletushkë, afishe, revista ilustruese, dramatizim, propozime për procedura, hapje të projekteve ose këndeve të reja për lojë, zbatim të trajnimeve të moshatarëve, ndihmë në bashkësi dhe produkte dhe aktivitete të tjera të ndryshme që rezultojnë nga tema dhe idetë e nxënësve. Megjithatë, në këtë lloj të nxënies, më i rëndësishëm është procesi përmes të cilit kalojnë nxënësit, meqë epilogët konkretë mund të jenë të pasigurt dhe ndonjëherë vështirë të realizueshëm.

#### V.4.3. DISKUTIM, DEBAT DHE LUAJTJE E ROLEVE

Diskutim, debat dhe luajtje e roleve, janë metoda që mundësojnë të dëgjohet "zëri" autentik i nxënësve, si dhe të zhvillohen shkathtësitë e tyre për argumentimin e qëndrimeve dhe mendimeve dhe shprehjes kreative. Ato mund të përdoren në kuadër të projekteve dhe zgjidhjes së problemeve, por gjithashtu edhe në mënyrë të mëvetësishme.

**Diskutimi** si metodë mësimore përdoret për të shkëmbyer dituri, ide, mendime dhe qëndrime në grup, me ç'rast mësohet prej njëri-tjetrit. Shkathtësitë që zhvillohen përmes diskutimit siç janë: të dëgjosh të tjerët, diskutim i argumentuar, tolerancë dhe pranim i mendimeve të ndryshme janë pjesë e kompetencave qytetare dhe shumë shkathtësi të nevojshme për pjesëmarrje demokratike qytetare.

Diskutimi mund të përdoret si metodë e mëvetësishme ose si pjesë e nxënies përmes projektit ose nxënies përmes zgjidhjes së një problemi, ndërsa mund të praktikohet në situata shumë reale shkollore, e veçanërisht në format e pjesëmarrjes së nxënësve në zgjidhjen e problemeve reale në klasë dhe shkollë.

**Debati** është metodë mësimore në të cilën dy grupe të nxënësve me bindje të kundërta i mbrojnë në mënyrë të argumentuar qëndrimet e tyre (ose qëndrimet që u janë dhënë për t'i mbrojtur) në prani të dëgjuesve, me procedurë të përcaktuar paraprakisht. Me këtë rast, nxënësit duhet të mbledhin informacione relevante për çështjen që debatohet, t'i analizojnë faktet në favor ose kundër një qëndrimi/këndvështrimi të caktuar, të dinë t'i parashtrajnë në mënyrë bindëse. Shkathtësitë për debatim janë, gjithashtu, kompetenca të rëndësishme qytetare për përfaqësim të suksesshëm si anëtarë të grupeve të ndryshme për përfaqësimin ose gjatë vendimmarrjes në grupe formale, shoqata ku përfaqësohen interesat e ndryshme.

Debati mund të realizohet në mënyrë të mëvetësishme ose nga ana tjetër në kuadër të nxënies përmes zgjidhjes së një problemi, pas ndonjë hulumtimi autentik ku rezultatet nga dy grupet shpijnë drejt konstatimeve të ndryshme, si dhe si pjesë e aktiviteteve jashtëshkollore.

**Luajtja e roleve** është teknikë e nxënies në të cilën nxënësit marrin ose përpilojnë skenar, pranojnë role të caktuara dhe fillojnë bashkëveprimin përmes personazheve të tyre. Nxënësit vihen në rolin e personit me problem të caktuar, me rol ose qëndrim të caktuar dhe i shqyrtojnë ndikimet e problemeve, roleve, qëndrimeve mbi aktivitetet e njeriut në botën përreth nga perspektiva e atij personi. Me këtë rast, nxënësit mund të "krijojnë" rolin në mënyrë të mëvetësishme në përputhje me qëndrimet dhe vlerat personale, ose nga ana tjetër të diskutojnë përshtatshmërinë e sjelljes në skenarë dhe role paraprakisht të caktuara. Personazhi mund të jetë i imagjinuar, i vërtetë ose nga e kaluara historike. Pas simulimit të realizuar (luajtja e situatës) edhe nxënësit edhe vëzhguesit bisedojnë për përjetimet, sjelljet, epilogun e situatës. Mësimdhënësi e përpilon situatën dhe ka rolin e moderatorit të diskutimit.

Përmes luajtjes së roleve në mjedis të kontrolluar dhe të sigurt praktikohen shkathtësi të nevojshme në situata që (mund të) ndodhin në jetën reale. Këto mund të jenë shkathtësi për përballje me emocione, zgjidhje të konflikteve, zhvillim të ndjeshmërisë, tejkallim të paragjyqimeve.

Luajtja e roleve mund të përdoret me sukses veçanërisht në lëndët mësimore nga shkencat shoqërore dhe artet, si dhe në aktivitetet jashtëshkollore për mbështetjen e zhvillimit personal dhe social të nxënësve.

## V.5. NDJEKJE DHE NOTIM I TË ARRITURAVE

Qëllimi themelor i notimit të nxënësve dhe matjes së të arriturave në arsimin qytetar është që të kontribuojnë në arritjen e standardeve për arsim qytetar që janë përkufizuar me standardin kombëtar për fushën *VI. Kulturë dhe qytetari demokratike*. Më konkretisht, duhet të sigurojë informacione relevante për nxënien, sjelljen dhe përgatitjen e nxënësve për përfshirje në jetën shoqërore dhe qytetare që do t'u shërbejnë mësimdhënësve, shkollës, bashkësisë lokale dhe kreatorëve të politikave arsimore në planifikimin dhe realizimin e arsimit qytetar.

Notimi dhe matja e të arriturave në arsimin qytetar është proces kompleks së pari, për shkak se kompetencat qytetare janë komplekse vetvetiu, së dyti, për shkak se në shkollë zhvillohen situata të ndryshme mësimore dhe jashtëshkollore përmes: (1) studimit të lëndës mësimore arsim qytetar, (2) studimit të përmbajtjeve nga arsimit qytetar në lëndë të tjera mësimore (kryesisht nga fusha shoqërore), (3) aktiviteteve jashtëshkollore dhe (4) pjesëmarrjes së nxënësve në aktivitetet e bashkësisë së nxënësve; por zhvillohen edhe nën ndikimin e fuqishëm të kontekstit jashtë shkolle (familje, moshatarë, mjedis më i gjerë shoqëror).

Situatat e prezantimit, matjes dhe notimit të të arriturave në arsimin qytetar kryesisht duhet të shikohen si mundësi për nxënie dhe zhvillim të kompetencave për pjesëmarrje qytetare dhe demokratike. Parimet dhe mënyrat e notimit janë në korrelacion me qëllimet, parimet dhe mënyrat e nxënies së qytetarisë dhe zhvillimit të kulturës demokratike. Me këtë rast duhet të merret parasysh se



nuk notohet se sa është nxënësi (i përgatitur të jetë) “qytetar i mirë”, por notohet cilësia e nxënies<sup>39</sup> në arsimin qytetar.

### V.5.1. NOTIM FORMATIV DHE SUMATIV NË ARSIMIN QYTETAR

Teori konstruktive të nxënies sugjerojnë se nxënësi është faktor aktiv në nxënien personale, prej çka rezulton se në notimin në arsimin qytetar theksi duhet të vihet në notimin formativ (notim që ka për qëllim të përmirësojë nxënien). Notimin formativ e bëjnë mësimdhënësit, ndërsa nxënësit duhet të kenë rol aktiv në atë proces. Nxënësit duhet ta kenë të qartë se çfarë kompetencash pritet të zhvillojnë, çfarë duhet të dinë, për çfarë janë të aftë dhe çfarë (mund) të bëjnë si anëtarë aktivë të bashkësisë dhe shoqërisë. Mësimdhënësit i nxisin nxënësit që të vendosin afate më afatshkurtra dhe më afatgjate për zhvillimin personal si qytetarë dhe t’u mundësojnë të marrin pjesë në vlerësimin e punës personale dhe përparimit në nxënien dhe arritjen e qëllimeve. Mësimdhënësit duhet në procesin e nxënies t’u japin informacione kthyesë të gjithë nxënësve për atë se si përparojnë dhe në bazë të kësaj – me secilin nxënësi t’i përcaktojnë aktivitetet e radhës për nxënie.

Të arriturat në arsimin qytetar notohen edhe në mënyrë sumative në mënyrë që të dihet se çfarë është arritur në fund të një periudhe të shkurtër të nxënies. Notimi sumativ ka të bëjë me grumbullimin sistematik dhe periodik të informacioneve në mënyrë që të vlerësohet se në çfarë niveli janë arritur rezultatet nga nxënia ose janë plotësuar disa standarde të caktuara për arritje. Gjatë notimit sumativ në arsimin qytetar veçanërisht duhet pasur kujdes se si do të përkufizohet dhe interpretohet kriteri për sukses. Notat e ulëta në asnjë rast nuk guxojnë të interpretohen si jokompetencë qytetare/demokratike, mospërshtatje për jetë në shoqëri demokratike, etj.

#### Notimi formativ i kompetencave të arritura qytetare të nxënësve

Metodat e notimit janë të lidhura ngushtë me metodat e mësimin dhe nxënies. Meqë rekomandohet që në arsimin qytetar të përdoren metoda të nxënies aktive në kontekste të ndryshme (në klasë, shkollë dhe jashtë shkolle) dhe përmes pjesëmarrjes së nxënësve në jetën në paralele, shkollë dhe bashkësi, në notimin formativ duhet të përdoret diapazon i gjerë i metodave të ndryshme që do të mundësojnë të notohen, si dimensionin kognitiv (dituri dhe mirëkuptim), ashtu edhe afektiv (besim, qëndrime) dhe praktik (shkathtësi, pjesëmarrje, sjellje) i kompetencave për kulturë dhe qytetari demokratike.

Në notimin formativ njëri prej parimeve kyçe është përfshirja e nxënësve në notimin përmes vetënotimit dhe notimit të ndërsjellë. Përmes vetënotimit nxënësit, duke notuar punimet dhe përgjigjet personale, e vlerësojnë diturinë personale, u bëhet më e qartë se çfarë dhe si duhet të dinë, më të qarta u janë kriteret e suksesit dhe shpesh marrin pjesë në vendosjen e tyre, vlerësojnë se në çfarë vëllimi i plotësojnë kriteret e vendosura dhe vendosin qëllime personale për nxënie.

Nxënësit në notimin formativ përfshihen në notimin e bashkënxënësve. Kjo mund të bëhet përmes përcaktimit të përbashkët të kriterëve për notim dhe përzgjedhje të shabllonit, p.sh. ese që i plotësojnë kriteret, përmes notimit të ndërsjellë të punës kur punojnë në çifte, përmes dhënies së informacioneve kthyesë për atë se si disa përgjigje/punime mund të përmirësohen. Me përfshirjen e nxënësve në notimin, veçanërisht në notimin e ndërsjellë, ata aftësohen, të jenë objektiv, të argumentojnë mendimin, të jenë të drejtë dhe të kenë kujdes se si do ta shprehin notimin, e me këtë rast të mos e demotivojnë dhe/ose lëndojnë bashkënxënësin, e me këtë vetë notimi paraqet mundësinë për përvetësimin e kompetencave qytetare.

<sup>39</sup> P.sh. me sa sukses nxënësi i përdorë informacionet që i ka në dispozicion për ta treguar të kuptuarit e dukurive dhe proceseve shoqërore, si i analizon proceset nga fusha e arsimit qytetar, si i argumenton këndvështrimet personale dhe me cilat argumente i mbrojnë ose mohojnë këndvështrimet e huaja, si i analizon në mënyrë kritike zhvillimet, si planifikon projekte ose aktivitete hulumtuese, si nxjerrë konstatime nga hulumtimi, si gjeneron dhe arsyeton ide për aktivitete qytetare, etj

Me përfshirjen e nxënësve në notim, një pjesë e përgjegjësive për vendimmarrje në procesin e nxënies bartet nga mësime të mësuara në nxënies. Në këtë mënyrë notimi bëhet më i besueshëm, ndërsa nxëniesit mësohen të bëhen qytetarë vetëkritik.

Në mënyrë që notimi formativ të jetë efektiv duhet të përdoren metoda që mundësojnë të manifestohen kompetencat në situata reale dhe të merren informacione për gamën e gjerë të rezultateve nga nxënies. Më poshtë janë përmendur disa metoda dhe teknika të notimit që e mundësojnë këtë, e këto në të shumtën e rasteve janë të ndërlidhura me aktivitete praktike të nxënësve në nxënies.<sup>40</sup>

- Notim i projekteve të nxënësve dhe hulumtimeve – Projektet e lidhura me zhvillimin e kompetencave qytetare (p.sh. projekt për uljen e dhunës moshatare) mundësojnë që të notohet aftësimi për: identifikimin e një problemi shoqëror; analizë dhe diskutim për arsyet dhe mundësitë për zgjidhjen e problemit; identifikim i kompetencave të institucioneve; komunikim në kontekste të ndryshme; bashkëpunim; prezantim dhe argumentim, etj.
- Notim i realizimeve praktike – Zgjidhja e një problemi të caktuar real shpesh nënkupton përgatitjen e ndonjë produkti praktik, me ç'rast është me rëndësi të respektohet një renditje e caktuar e aktivitetit dhe të sigurohet cilësi e produktit. Për shembull, të shkruhen letra përmes të cilave nxëniesit do t'i bindin institucionet në bashkësi që të angazhohen në zgjidhjen e ndonjë problemi të rëndësishëm për nxëniesit. Me këtë rast mund të notohet p.sh. suksesi në identifikimin dhe formulimin e problemit, përshtatshmëria e identifikimit të personit/institucionit përgjegjës për zgjidhjen e tij, përshtatshmëria e llojit dhe formës së letrës, përmbajtjes, argumentimit, përshtatjes së stilit me dedikimin, etj.
- Notimi i sjelljes përmes vëzhgimit – Në situatat reale të sjelljes në klasë dhe shkollë manifestohen shumë prej kompetencave për sjellje qytetare dhe demokratike. Si rrjedhojë, vëzhgimi i strukturuar dhe udhëheqja e shënimeve anekdotike mundëson që mësime të mësuara të grumbullojnë informacione dhe të vlerësojnë në çfarë shkallë janë përvetësuar disa kompetenca të caktuara. Përmes diskutimit për sjelljen e pjesëmarrësve në një situatë të caktuar nxëniesit mund të përfshihen në notimin, e kjo njëherësh është mundësi për nxënies.

Arsimi qytetar përfshin edhe kompetenca për sjellje në situata të ndjeshme shoqërore (p.sh. diskriminim, stereotipa, etj.) për zhvillimin dhe notimin e të cilave mund të realizohen **simulime** të sjelljes ose **luajtje e roleve** në situata të imagjinuara. Në vëzhgimin e sjelljes së nxënësve në situata të këtilla mund të notohet të kuptuarit e roleve, relacioneve, ndjeshmërisë, qëndrimeve, vlerave të caktuara, etj. Aktivitetet e këtilla mund të jenë të përcjella me refleksion ose me diskutim mes bashkënxënësve që do t'u ndihmojnë t'i kuptojnë sjelljet personale dhe sjelljet e të tjerëve.

Vëzhgimi i sjelljes në **diskutim** për një çështje të caktuar mundëson që të notohen dituritë, të kuptuarit, qëndrimet, vlerat, aftësitë për argumentim, bindjet, etj. të numrit më të madh të nxënësve njëherësh edhe në situatë që është reale ose e afërt me realen (Shembulli 4). Në notimin formativ të diskutimit mund të përfshihen edhe nxëniesit përmes vetënotimit dhe notimit të ndërsjellë.

#### Shembulli 4: Notim përmes vëzhgimit të sjelljes në diskutim grupor

Në njërën prej orëve nga arsimi qytetar në klasën e nëntë, mësime të mësuara ka planifikuar që të përpunohet përmbajtja për identitet personal dhe grupor përmes zbatimit të diskutimit grupor mes nxënësve në temën “Mbajtja e uniformave duhet të jetë e detyrueshme në të gjitha shkollat fillore”, si dhe refleksion dhe evaluim. Në përgatitjen ditore, mësime të mësuara ka parashikuar zhvillimin dhe notimin e kompetencave vijuese qytetare të nxënësve: shkathtësi për analizë kritike të ndikimeve të ndryshme mbi formimin e mendimeve, sjelljeve, veshjeve të dikujt dhe ngjashëm; raport kritik ndaj ndikimeve të ndryshme mbi to si individ; tregim i mirëkuptimit për interesat e njerëzve të tjerë dhe

<sup>40</sup> Metodatat e mësimit dhe nxënies janë përshkruar më hollësisht në kapitullin 5.4.

tolerancë ndaj të njëjtave; si dhe sjellje që reflekton tolerancë për pikëpamje të ndryshme dhe aftësi për sqarimin dhe mbrojtjen e qëndrimeve të tyre.

Mësimdhënësja i informon nxënësit cilat dituri dhe shkathtësi pritet ata t'i shfrytëzojnë në diskutim.

Mësimdhënësja vendosë se cilët nxënës (më së shumti tre) do t'i vëzhgojë në mënyrë të fokusuar dhe do t'i notojë në mënyrë sumative. Për këtë qëllim parapakisht ka përpiluar çek-listë me të cilën do ta notojë përmbajtjen dhe formën e qëndrimeve të shprehura, duke i kushtuar vëmendje të veçantë asaj se sa nxënësit i dinë përmbajtjet mësimore që janë të rëndësishme për debatin (p.sh. çfarë është identitet personal e çfarë grupor, si formohen të njëjtat, cila është rëndësia e tyre në periudhat e ndryshme të moshave), si e zhvillojnë argumentimin e tyre përmes përdorimit të informacioneve nga përmbajtjet mësimore, çfarë rrjedhe logjike kanë argumentet, përshtatshmëria e shembujve që i përdorin nxënësit gjatë sqarimit të argumenteve personale, si i hedhin poshtë/mohojnë argumentet e bashkënxënësve, aftësia për të dëgjuar tjetrin dhe për të respektuar mendimin e huaj. Shënimet nga çek lista do t'i krahasojë me kriteret objekteve të përkufizuara parapakisht për suksesin e nxënësve në përvetësimin e përmbajtjeve mësimore dhe kompetencave të parashikuara. Kriteret për suksesin duhet parapakisht t'u jenë të njohura nxënësve, e edhe më mirë nëse janë përpiluar në bashkëpunim me ta.

Për nxënësit tjerë mësimdhënësja bën shënime anekdotike që do t'i shfrytëzojë gjatë dhënies së informacionit formativ kthyes individual për secilin nxënës.

Gjatë diskutimit, mësimdhënësja e ndjekë edhe shprehjen e vlerave që i shprehin nxënësit (p.sh. individualizmin përballë kolektivizmit, liberalizmin përballë tradicionalizmit), por të njëjtët nuk i vlerëson në mënyrë sumative. Lidhur me vlerat e nxënësve dhe harmonizimin e tyre me kompetencat që duhet të zhvillohen me programin, mësimdhënësja mund t'i japë informacion verbal kthyes gjithë paraleles që ka të bëjë me vlerat e dëshiruara në një shoqëri demokratike, por nuk duhet t'i kritikojë qëndrimet dhe vlerat e nxënësve nëse ato nuk janë të harmonizuara me vlerat e dëshiruara.

Mësimdhënësja në fund të diskutimit i përfshin edhe nxënësit përmes vetënotimit (mund ta përdorin çek listën e njëjtë që ajo e ka përdorur për vëzhgim të fokusuar të tre nxënësve) dhe notim moshatar, me ç'rast thekson se qëndrimet dhe vlerat e tyre personale nuk duhet të ndikojnë në notimin e bashkënxënësve të tyre.

- **Notim i eseve dhe prezantime gojore** – Esetë janë metodë shpesh e përdorur për notimin e arsimit qytetar për shkak se mundësojnë që të kontrollohen dituria dhe të kuptuarit e koncepteve, marrëdhënive, problemeve, aftësia për grumbullimin e informacioneve relevante, argumentimi, diskutimi. Mundësi të ngjashme ofrojnë edhe prezantimet gojore të përgatitura parapakisht për një temë të caktuar. Për notimin e tyre nevojitet që parapakisht të jenë indikatorë të caktuar që do t'u ndihmojnë nxënësve për të ditur se çfarë është me rëndësi të tregojnë se e dinë dhe për çka janë të aftë.
- **Notim i nxënies përmes ditarëve reflektiv** – Ditarët reflektiv ose ditarët për nxënie udhëhiqen nga nxënësi dhe mund të jenë pjesë shoqëruese e ndonjë aktiviteti më të ndërlikuar. Në to, në faza të caktuara të aktivitetit, shënohet nxënia (çfarë është mësuar, çfarë ka paraqitur problem), mendimet, qëndrimet e nxënësit. Kjo metodë është veçanërisht e pasur me të dhëna gjatë realizimit të nismave të nxënësve, përmes të cilave nxënësit duhet të ndërlidhin përvojën e tyre në bashkësi me rezultatet e nxënies.

- Notim i aktivitetit në bashkësinë e paraleles dhe parlamentit të nxënësve – Të gjithë nxënësit janë përfshirë në punën e bashkësisë së paraleles, e disa janë edhe në trupat e parlamentit të nxënësve. Kjo krijon situata të mirëfillta, reale për aktivitet në bashkësinë e tyre. Nxënësit duhet të dinë se si pjesëmarrja aktive në punën e bashkësisë së paraleles është e ndërlidhur me nxënien për qytetari demokratike dhe se kjo vlerësohet pozitivisht, ndonëse nuk është pjesë e notës për lëndën arsim qytetar.

### **Notim sumativ i kompetencave të arritura qytetare të nxënësve**

Ndonëse shumica e metodave të notimit nuk përdoren vetëm për notim formativ ose vetëm për atë sumativ, numri më i madh i metodave të përmendura më sipër që janë shumë të përdorura për notim formativ nuk janë aq përkatëse për notimin sumativ, kryesisht për shkak se, pak a shumë, bazohen në vlerësime subjektive.

Si rrjedhojë në notimin sumativ, veçanërisht atë që ka reperkusione të rëndësishme për nxënësit, në të shumtën e rasteve përdoren metoda objektive që kryesisht kontrollojnë diturinë dhe të kuptuarit e shoqërisë qytetare, si dhe shkathtësi të caktuara për kulturë demokratike dhe pjesëmarrje demokratike. Më poshtë janë përmendur disa metoda që janë më adekuate për notimin sumativ nga lënda e arsimit qytetar dhe janë potencuar momentet kyçe për të cilat duhet pasur kujdes.

- Notim me pyetje të esesë - Pyetjet e esesë kërkojnë që nxënësi të japë përgjigje të shkurtër ose të gjerë në të cilën do të mund të tregojë faktet që i njeh, të kuptuarit e dukurive dhe proceseve dhe të shprehë qëndrime dhe mendime që do t'i argumentojë. Ato mundësojnë notimin e kompetencave që kërkojnë procese më të larta mendore siç janë analiza, sinteza, vlerësim, për çfarë rekomandohet në esencë çështja të jetë situatë problemi edhe në çështjen ose udhëzimet për nxënësin të jetë e qartë se çfarë kërkohet (p.sh. analizë e situatës, përkufizim i problemit, ofrim i zgjidhjeve me karakteristika të caktuara, argumentim, etj.).
- Notim me pyetje me më shumë zgjedhje ose plotësim – Te këto lloje të pyetjeve zakonisht kontrollohet njohja dhe ndërlidhja e fakteve, dukurive dhe proceseve. Me to mund të kontrollohen edhe procese më të ndërlikuara kognitive nëse çështjet janë të bazuara në një situatë hipotetike të përpiluar mirë (nga jeta e përditshme në shoqërinë qytetare).
- Notim i prezantimeve gojore – Gjatë notimit të prezantimeve gojore, detyra duhet të jetë e përpiluar dhe strukturuar mirë, të kërkojë që prezantimi të tregojë të kuptuarit e problemit/çështjes dhe, nëse ky është qëllimi, edhe njohje të mënyrave përkatëse të prezantimit. Detyra duhet të jetë e përcjellë në udhëzim të përpunuar dhe konkret për notim që përmban çfarë dhe si do të vlerësohet dhe kjo duhet t'u jetë e njohur nxënësve para se të marrin detyrën, në mënyrë që të mund ta përgatisin dhe prezantojnë përgjigjen në mënyrë përkatëse.
- Notim i portofolit reprezentativ – Portofoli reprezentativ është përmbledhje e punimeve më të mira të nxënësit. Përmbajtja e portofolit reprezentativ duhet të jetë e përkufizuar paraprakisht, për shembull të përmbajë ese, tekst tematik, raport nga ndonjë projekt individual. Për çdo lloj punimi në portofolin reprezentativ duhet të jetë i përpiluar udhëzimi për notim, si dhe të përcaktohen rregullat dhe kriteret për atë se si nota e çdo punimi të caktuar do të ndikojë në

notën sumative. Portofoli reprezentativ zakonisht përdoret për notimin e të arriturave të ndryshme në një periudhë më të gjatë kohore p.sh. në tremujor, gjysmëvjetor.

## V.6. ROLI I DREJTORISË SË SHKOLLËS NË ZHVILLIMIN E KOMPETENCAVE QYTETARE TË NXËNËSVE

Nëse shkolla ka për qëllim të ndërtojë qytetarë që do të marrin pjesë në mënyrë demokratike dhe aktive në jetën në bashkësi, atëherë që në mjedisin e tij duhet të krijojë kushte për ndërtimin gradual të tyre. Si rrjedhojë, të gjitha format e përmendura më sipër të zbatimit të arsimit qytetar duhet të jenë pjesë përbërëse e politikave shkollore dhe të mbështetura nga drejtoria e shkollës, përmes praktikave shkollore. Në mënyrë plotësuese, drejtoria e shkollës duhet të vendosë shembuj dhe të nxisë përfshirje konkrete demokratike dhe veprimin e të gjithë faktorëve në shkollë në segmente të ndryshme të funksionimit të shkollës, veçanërisht në procesin e vendimmarrjes.

Pjesëmarrja e nxënësve ka rëndësi të veçantë shoqërore nëse merret parasysh se është mënyra më e mirë që nxënësit të njoftohen me vlerat demokratike, t'i pranojnë ato dhe prej tyre të udhëhiqet sjellja e nxënësve.<sup>41</sup> Nxënësit kryesisht duhet të nxiten për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve në paralele dhe shkollë, ndërsa lloji i pjesëmarrjes, varësisht nga problemi, mund të jetë në nivele të ndryshme:

1. Nxënësit janë konsultuar për mendimin që do ta shprehin lirshëm, ndërsa të rriturit do ta marrin parasysh atë gjatë marrjes së vendimit;
2. Nxënësit marrin vendime të mëvetëshme dhe obligohen që edhe t'i zbatojnë vetë ose bashkë me të rriturit, ose
3. Vendimi merret bashkërisht në një proces në të cilin marrin pjesë edhe të rriturit edhe nxënësit.<sup>42</sup>

Krahas pjesëmarrjes në aktivitete në paralele dhe shkollë, ekzistojnë shumë mundësi për të promovuar dhe forcuar pjesëmarrjen e të rinjve në aksione jashtë shkollës – në nivel lokal, rajonal, kombëtar, ndërkombëtar. Në të gjitha nivelet e përfshirjes së nxënësve në marrjen e vendimeve, të rriturit janë të domosdoshëm për t'u dhënë mbështetje dhe ndihmë, por edhe të përkujdesen që procesi i përfshirjes së të rinjve të jetë përkatës. Me këtë rast është shumë e rëndësishme që format e tilla të mos barazohen me simulimin e të drejtave dhe përgjegjësive që, që tani duhet të përvetësohen, por t'u sigurojnë nxënësve përvojë të mirëfilltë dhe përgjegjësi të ndërlidhura me ndikimin përkatës të tyre mbi marrjen e vendimeve për çështje që janë në interes të jetës së nxënësve në shkollë dhe jashtë saj. Nxënësit mund të jenë të përfshirë në mënyra të ndryshme dhe në nivele të ndryshme të vendimmarrjes për të gjitha gjërat që u interesojnë atyre ose do të mund të ishin në interesin e tyre në shkollë. Tabela e radhës ofron shembuj të pjesëmarrjes së nxënësve në kontekste të ndryshme.

<sup>41</sup> Neni 12 nga Konventa për të drejtat e fëmijës jo vetëm që ua jep të drejtën, por edhe i obligon shkollat që t'i mësojnë nxënësit për udhëheqje dhe sundim demokratik në atë mënyrë që do të sigurojnë forma të organizuara të shprehjes aktive të lirshme dhe përfshirje të nxënësve në proceset demokratike.

<sup>42</sup> Mënyrat e përfshirjes janë arsyetuar në *Doracakun për pjesëmarrje të nxënësve, organizim të nxënësve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në shkollat fillore* (I kapshëm në: [https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2020/02/Vodic-za-ucenicko-uchestvo-i-organiziranje\\_MK.pdf](https://www.bro.gov.mk/wp-content/uploads/2020/02/Vodic-za-ucenicko-uchestvo-i-organiziranje_MK.pdf)).

<b>Nxënie, mësim dhe notim</b>	Nxënësit duhet të kenë mundësi për të marrë pjesë dhe në një masë të caktuar të ndikojnë në përcaktimin e përmbajtjeve që mësohen, mënyrës në të cilën mësojnë dhe metodat përmes të cilave janë notuar.
<b>Mundësi për zhvillim personal</b>	Nxënësit kanë të drejtë të ndikojnë në vendime të ndryshme të rëndësishme për jetesën e tyre në shkollë dhe bashkësi. Pyetjet që ngrihen dhe aktivitetet që ndërmerren mund të jenë të iniciuara nga vetë nxënësit ose të përfshijnë bashkëpunim me mësimdhënës, grupe në bashkësi, institucione, organizata qytetare dhe trupa të tjerë. Përmes angazhimit në këtë fushë, nxënësit mund të ndikojnë konsiderueshëm në kulturën demokratike në shkollë. Shembuj për aktivitete të këtilla janë: vullnetarizmi, garat, vizitat në institucione dhe mysafirë-oratorë, grumbullimi i mjeteve për arritjen e një qëllimi të caktuar, ngjarjet publike dhe ngjashëm.
<b>Trupa formale për marrjen e vendimeve</b>	<p>Nxënësit janë të përfshirë në punën e trupave të caktuara formale në shkollë në të cilat merren vendime që u interesojnë, siç janë: bashkësia e paraleles; parlamenti i nxënësve; Këshilli i arsimtarëve, ndërsa me vetiniciativë mund të kërkojnë përfshirje edhe në punën e trupave të tjerë kur vendosin për çështje që janë të rëndësishme për ta, si p.sh. Këshilli i prindërve.</p> <p>Përmes këtyre formave të organizimit, nxënësit mund të marrin pjesë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përfaqësimin dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të nxënësve,</li> <li>• promovimin e aktivizmit të nxënësve,</li> <li>• përgatitjen e programit vjetor për punë,</li> <li>• dhënien e propozim aktivitetëve për programet vjetore për ekskursione,</li> <li>• dhënien e propozimeve për aktivitete jashtëshkollore të shkollës,</li> <li>• dhënie e propozimeve për përmirësimin e standardit të nxënësve,</li> <li>• pjesëmarrjen në evaluimin e punës së shkollës,</li> <li>• vendimet që merren në këshillin e prindërve dhe këshillin e mësimdhënësve, përmes përfaqësuesve të tyre,</li> <li>• organizimin dhe pjesëmarrjen në aktivitete humanitare, aktivitete ekologjike dhe punë të dobishme shoqërore.</li> </ul>
<b>Në korrelacion me bashkësinë më të gjerë</b>	<p>Kjo fushë mbulon çështje nga sfera e vendosjes së partneriteteve dhe bashkëpunimit me bashkësinë më të gjerë (prindër/kujdestarë, njësi e vetëqeverisjes lokale, sektori afarist, institucionet, etj.), me ç'rast shkolla ka funksionuar si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ndërmjetësues për përfshirjen e nxënësve në jetën shoqërore në bashkësinë lokale dhe</li> <li>• ndërmjetësues për përfshirjen e bashkësisë lokale në aktivitetet shkollore.</li> </ul> <p>Në këtë fushë të krijimit të partneriteteve në bashkësinë lokale, nxënësit stimulohen për vendosjen e dialogut ndërmjet gjeneratave, përmes përfshirjes aktive të tyre në jetën shoqërore. Në këtë mënyrë do të nxitet vetëdija për rëndësinë e kontributit të tyre në bashkësinë. Iniciativat për vendosjen e bashkëpunimit mund të rezultojnë ose vetëm prej nxënësve, ose në konsultim me palët tjera të interesuara.</p>

Pjesëmarrja e nxënësve në menaxhimin demokratik në shkollë është e rëndësishme, meqë:

1. **Përmirëson përgjegjësinë e nxënësve.** Nxënësit të cilëve u është dhënë besimi për të marrë vendime, bëhen më të përgjegjshëm.
2. **Përmirëson nxënien.** Në një rrethim demokratik, nxënësve u jepet liri më e madhe për të zgjedhur se si të mësojnë dhe, së paku deri në njëfarë niveli, çfarë të mësojnë. Problemet me

mungesën e motivimit dhe interesimin e pamjaftueshëm për nxënie shpeshherë tejkalohen nëse nxënësit i lejohet liri më e madhe për të zgjedhur se çfarë dhe si të mësojë, e kur është e mundshme edhe të përzgjedhë se si të notohet.

3. **Zvogëlon dukurinë e konflikteve.** Demokratizimi i menaxhimit shkollor krijon ndjenjën e respektit dhe mirëkuptimit të interesave të ndryshëm, që ndikon në uljen e mundësisë për krijimin e situatave të konfliktit.
4. **Siguron ekzistimin e ardhshëm të demokracive të qëndrueshme.** Nxënësit në mënyrë më efektive do të përvetësojnë kompetenca për qytetari demokratik nëse kjo reflektohet në mënyrën e funksionimit të shkollës. Nevojitet që nxënësve t'u jepet mundësi për pjesëmarrje dhe ndikim thelbësor, dhe në këtë mënyrë ta mësojnë fuqinë dhe përgjegjësinë për vendimet në gjëra që janë kyçe për nxënien e tyre dhe jetën e tyre të përditshme në shkollë. Nëse nxënësit përvetësojnë shkathhtësi për t'u angazhuar për pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të mësojnë të praktikojnë sjellje demokratike në shkollë, të njëjtën gjë do ta bartin edhe në situata dhe periudha të tjera të jetës.

## V.7. BASHKËPUNIM ME BASHKËSINË

Shkollat duhet të jenë mjedisi demokratike dhe pjesë aktive dhe me ndikim nga bashkësia, ndërsa nga të gjithë faktorët në bashkësinë, duke përfshirë prindërit/kujdestarët, institucionet publike dhe private, organizatat qytetare dhe sektori afarist pritët të mbështesin shkollën.

Bashkëpunimi me bashkësinë mundëson krijimin e llojeve të ndryshme të lidhjeve dhe partneriteteve mes shkollave dhe të gjithë faktorëve në bashkësi. Partneritetet mund të përfshijnë: përdorim të objekteve dhe pajisjeve shkollore ose komunale, ndarje të resurseve, grumbullim të mjeteve financiare, ndërmarrje të përbashkët të ndonjë aktiviteti ose aksioni, aktivitete vullnetare, mentorim dhe trajnim prej profesionistëve, shkëmbim të informacioneve, ndërtim dhe mirëmbajtje të infrastrukturës, shërbim në bashkësinë dhe shumë të tjera.

Kur shkollat, prindërit/kujdestarët, familjet dhe bashkësia punojnë së bashku për mbështetjen e procesit të nxënies, partneritetet rezultojnë me cilësi të përmirësuar të programit, përdorim më efikas të resurseve dhe harmonizim më të mirë të qëllimeve dhe programeve mësimore.<sup>43</sup> Bashkëpunimi mes shkollave dhe bashkësisë mund të kontribuojë që të zgjidhen probleme të ndryshme shoqërore me të cilat përballen të rinjtë.<sup>44</sup>

Format e bashkëpunimit në bashkësinë në të shumtën e rasteve përfshijnë:

- **Bashkëpunim mes shkollës dhe komunës**

Njëra prej formave të bashkëpunimit mes shkollës dhe bashkësisë është organizimi i nismave rinore, vullnetare. Për organizimin e këtyre nismave nevojitet mbështetje e bashkësisë lokale (komunës). Mbështetja e këtillë nënkupton sigurimin e mjeteve financiare, hapësirave ose mbështetjes institucionale gjatë realizimit të aktiviteteve.

Në mënyrë plotësuese, në mënyrë që t'u mundësohet nxënësve qasje deri te arsimit plotësues dhe që të nxitet pjesëmarrja demokratike të rinjtë, nevojitet që nxënësit të njoftohen me institucionet në bashkësinë e tyre. Prandaj është me rëndësi të vendoset bashkëpunim me komunën që do të mundësojë vizitë të rregullt në institucionet më të rëndësishme që punojnë në atë komunë.

<sup>43</sup> Harvard Family Research Project. (2010). Partnerships for Learning: Promising Practices in Integrating School And Out-of-School Time Program Supports.

<sup>44</sup> Little, P. (2013). School-Community Learning Partnerships: Essential to Expanded Learning Success. *Expanding and Opportunities*, 71.

- **Bashkëpunim mes shkollës dhe organizatave qytetare**

Organizatave qytetare që punojnë në bashkësinë lokale mund të mundësojnë lloje të ndryshme të bashkëpunimit varësisht nga gama e punës së tyre. Derisa disa organizata mund të sigurojnë trajnime, mentorim ose arsim plotësues joformal, organizata të tjera mund të sigurojnë mbështetje financiare ose logjistike gjatë organizimit të aksioneve dhe nismave rinore. Veçanërisht janë të rëndësishme organizatat rinore që kanë zhvilluar metodologjinë e punës me fëmijë që do t'u mundësojë nxënësve që të përvetësojnë dituri plotësuese jashtë arsimit formal.

- **Bashkëpunim mes shkollës dhe bashkësisë afariste**

Ekzistojnë forma të ndryshme të bashkëpunimit dhe partneriteti mes shkollave dhe bashkësisë afariste që janë me interes të ndërsjellë. Për shembull, bashkësia afariste mund të sigurojë financim të drejtpërdrejt, zhvillim profesional, donacion të mallrave dhe shërbimeve, fuqi punëtore, mentorim, etj., ndërsa shkolla siguron kuadër të ardhshëm me shprehje të punës, iniciues dhe të përgatitur për pjesëmarrje demokratike.

- **Bashkëpunim mes shkollës dhe prindërve/kujdestarëve**

Bashkëpunimi mes shkollës dhe prindërve/kujdestarëve nënkupton krijimin e partneritetit mes kuadrit mësimor, shërbim profesional dhe familjes së nxënësve. Partneriteti efikas mbështetet në besimin dhe respektin e ndërsjellë, ku edhe të dyja palët e ndajnë përgjegjësinë për arsimin dhe socializimin e të rinjve në shkollë. Në mënyrë që të vendoset partneriteti efikas mes prindërve/kujdestarëve dhe shkollës nevojitet të nxitet autonomia e trupave udhëheqëse në të cilat marrin pjesë prindërit/kujdestarët dhe dhënie të mundësive për përfshirje në zbatimin e nismave rinore.

#### **Shembulli 5. Fushatë “Zëri i të rinjve në Helsinki”**

Fushata “Zëri i të rinjve në Helsinki” është projekt i përbashkët i Departamentit të Arsimit të Helsinkit dhe Departamentit për të Rinjtë të Helsinkit, vizioni i të cilit është “fëmijët dhe të rinjtë të ndjejnë se Helsinki është qytet në të cilin mund të dëgjohen dhe bëhen disa ndryshime të caktuara në pamjen e gjërave që i konsiderojnë të rëndësishme”. Qëllimi është që fëmijët dhe të rinjtë të zhvillohen në anëtarë aktiv të shoqërisë dhe të kenë “zë” gjatë marrjes së vendimeve në nivel të komunës.

Në nivel të shkollës, secila shkollë realizon punëtori në të cilat nxënësit (së pari sipas paraleleve, e më pas në nivel të këshillit të nxënësve) bisedojnë për probleme dhe ide që kanë të bëjnë me mjedisin shkollor, votojnë për to dhe përzgjedhin një propozim që duhet ta arsyetojnë para Këshillit të Komunës dhe kryetarit të qytetit. Për shembull, përfaqësuesi 11 vjeçar i shkollës fillore “Roihovuri” i ka përfaqësuar nevojat për vendosjen e dollapëve në shkollë për nxënësit më të rritur dhe pajisje për këndin për lojë për nxënësit më të vegjël, dhe kanë arritur të marrin mjete për këto nevoja. Në mënyrë plotësuese, nxënësit kanë marrë edhe mjete plotësuese për t’iu përgjigjur nevojave të shkollës që kanë të bëjnë me integrimin ndërkulturor, duke marrë parasysh përbërjen multietnike të nxënësve.

Burimi: Expert meeting CE: Collection of school portraits. Europees Platform, Netherlands National Commission for UNESCO, June 2004. I kapshëm në: <https://cutt.ly/Hscpcxy>

## **V.8. KOMPETENCA TË MËSIMDHËNËSVE PËR PËRCJELLJEN E DITURIVE, SHKATHTËSIVE DHE QËNDRIMEVE TE NXËNËSIT PËR KULTURËN DEMOKRATIKE DHE QYTETARINË**

Njëra prej detyrave të mësimdhënësit është që të krijojë praktika demokratike në klasë gjatë realizimit të mësimin të rregullt nga të gjitha lëndët. Kjo do të thotë të krijojnë atmosferë të besimit se klasa është hapësirë e sigurt ku nxënësit mund të ndajnë përvoja, klasa është vend për diskutim dhe vend ku zhvillohen procese të marrjes së vendimeve, të krijojë frymë të bashkëpunimit dhe mjedis për nxënie,



respektim të nxënësve dhe motivim të tyre, angazhimin dhe sigurimin e mësimin, me nxënësin në qendër.<sup>45</sup>

Mësimdhënësi është jashtëzakonisht i rëndësishëm në procesin e nxënies dhe praktikimit të demokracisë. Mësimdhënësi duhet të ketë vlera të larta demokratike, të ketë liri, të drejtë, autonomi dhe autenticitet dhe të mundet në bashkëpunim me nxënësit të marrë vendime të rëndësishme për nxënësit, shkollën dhe mjedisin.<sup>46</sup> Ai/ajo duhet të tregojë respekt ndaj nxënësve përmes vendosjes së trupave për marrjen e vendimeve dhe ndërmjetësimit mes moshatarëve, duke u lejuar nxënësve të organizojnë ngjarje të tyre dhe të hulumtojnë për çështje të ndryshme shoqërore, të diskutojnë, të shprehin mendime, të debatojnë dhe të propozojnë strategji për menaxhimin e konflikteve. Me sjelljen, fjalën e tyre, mësimdhënësit mund të tregojnë se të gjitha përgjigjet dhe përvojat e ndryshme të nxënësve janë po aq të pranueshme. Prania e mendimeve dhe qëndrimeve të ndryshme të nxënësit është dëshmi për besimin dhe lirinë e mendimit dhe fjalës, me të cilat fillojnë nxënësia dhe zhvillimi.<sup>47</sup>

Mësimdhënësit vëmendje të veçantë duhet të kushtojnë që gjatë mësimin të respektohen të gjitha parimet e arsimit qytetar, të krijojnë klimë demokratike, nxënësit të nxjerrin mendimin e tyre, të ndërtojnë sistem të vlerave në frymën e bashkëpunimit, humanitetit, eupatisë, komunikimit të padhunshëm, mosdiskriminimit dhe respektimit të diversiteteteve përmes aktiviteteve hulumtuese, punëtorive të projektit, nismave të nxënësve dhe metodave të tjera aktive të nxënies.

Lidhur me lëndën arsim qytetar, bëhet fjalë për fushë që është interdisciplinare dhe prej mësimdhënësve pritet të integrojnë fusha të ndryshme në mësimin e tyre (dimensione politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore). Për shkak të kësaj, është me rëndësi që mësimdhënësi të ketë autonomi lidhur me planifikimin e mësimin, në mënyrë që të njëjtin ta përshtatë me karakteristikat e nxënësve. Njëherësh, për shkak të natyrës së kompetencave qytetare që qëndrojnë nga aspekti i: diturisë dhe mirëkuptimit, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve, si dhe sjelljeve; metodat mësimore është e domosdoshme që t'i kombinojnë aspektet teorike me aktivitete ose projekte për përfshirje në bashkësinë dhe zhvillimin e qytetarisë kritike dhe të përgjegjshme.<sup>48</sup>

## VI. EVALUIM I KOMPETENCAVE TË ARRITURA QYTETARE

Të arriturat e nxënësve në arsimin qytetar mund të maten në nivel të shkollës ose në mënyrë eksterne (matjen ta zbatojë një institucion i pavarur). Matjet eksterne e të arriturave janë gjithashtu një lloj i notimeve sumative që, ndonëse nuk reflektohen te secili nxënës individualisht, kanë për qëllim që të matet se çfarë është arritur në nivel të shkollës ose shtetit në mënyrë që të rishqyrtohen/përmirësohen programet, praktikrat ose politikat arsimore në përgjithësi.

Rezultatet nga këto matje nuk ndikojnë në suksesin dhe avancimin e nxënësve. Rezultatet nuk duhet të paraqiten për secilin nxënës individualisht, por në mënyrë të agreguar në nivel të paraleles, vitit, sipas grupeve etj. dhe përdoren për përmirësimin e punës dhe programeve. Në këtë drejtim rekomandohet që arsimit qytetar të jetë pjesë e testimeve shtetërore/notimeve kombëtare që i zbaton Qendra

<sup>45</sup> Subba, D. (2014). Democratic values and democratic approach in teaching: A perspective. *American Journal of Educational Research*, 2(12A), 37-40.

<sup>46</sup> MacMath, S. (2008). Implementing a democratic pedagogy in the classroom: Putting Dewey into practice. *Canadian Journal for New Scholars in Education/Revue canadienne des jeunes chercheurs et chercheurs en éducation*, 1(1).

<sup>47</sup> A. Bllazheva dhe Zh. Çonteva (2010). Doracak për metoda dhe teknika bashkëkohore dhe kreative të nxënies. Qendra Algoritëm.

<sup>48</sup> Nogueira, F., & Moreira, A. (2012). A framework for civic education teachers' knowledge. *Procedia-Social and Behavioral Sciences*, 47, 1179-1183.

Shtetërore e Provimeve dhe të marrë pjesë në matjet ndërkombëtare e të arriturave në arsim qytetar<sup>49</sup>, ndërsa njohuritë dhe përvojat prej tyre të përdoren për përmirësimin e mësimin dhe notimit.

Në matjet e të arriturave të nxënësve në nivel të shkollës ose shtetit, krahas metodave që përdoren për notim sumativ, përdoren shkallë të qëndrimeve<sup>50</sup> me të cilat matet raporti ndaj çështjeve të caktuara për arsim qytetar, p.sh. qëndrime ndaj pranimin të diversiteteve, angazhimit shoqëror, korrupsionit, pranimin të qeverisjes demokratike/autokratike, etj. në mënyrë që të përcaktohen disa nga faktorët që janë të ndërlidhur me të arriturat që përdoren dhe pyetësorët për nxënës, mësimdhënës, prindër/kujdestar, drejtorinë e shkollës.

Në mënyrë plotësuese, të dhënat dhe evidenca për të arriturat e kompetencave për kulturë demokratike dhe qytetari i përdorë edhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit në evaluimin e punës së shkollës në përputhje me *Indikatorët për evaluim integral*.

---

<sup>49</sup> Për shembull, *Matje ndërkombëtare në arsimin qytetar* (International Civic and Citizenship Education Study); Shqyrtim i të a.q. Kompetencë Globale (Global Competence) që matet në kuadër të PISA hulumtimit të OECD-së.

<sup>50</sup> Shkallët e qëndrimeve janë vargje të pohimeve në të cilat kërkohet, për çdo pohim, të shënohet niveli i pranimin të tij (nga pranimi i tërësishëm deri te refuzimi i tërësishëm).

